



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË  
MBAJTUR MË 29 KORRIK 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE  
29. JULA 2011. GODINE**

**KORRIK – JULI  
2011**

**E premte, më 29.7. 2011,**

**Drejton seancën: Nënkrjetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti**

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,  
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,  
Hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.  
Në mbledhje janë të pranishëm 68 deputetë, andaj fillojmë me punimet e mbledhjes plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Zoti Sabri Hamiti ka kërkuar fjalën, për procedurë.

SABRI HAMITI: Zoti nënkryetar, Haliti,  
Duhet para Kuvendit të merret mendimi për pikën 4 dhe 5, sepse janë me procedurë të shpejtuar dhe duhet një mendim i Kuvendit para se të procedoni dy ligjet, në pikën 4 dhe pikën 5.

KRYESUESI: Faleminderit! Është paraparë, edhe më herët kur të vijmë te pika 4 edhe 5, apo e bëjmë tani? Mirë!

Po e lëmë, kur të vijmë te pikat përkatëse e diskutojmë. Mirë. Faleminderit!

Atëherë, pika e parë e rendit të ditës është:

### **1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave**

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që para jush të paraqes Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave. Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave është miratuar në Qeveri më 29.6. të vitit 2011. Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji qëndron në përmbushjen e obligimeve kushtetuese, si dhe në përcaktimin e kompetencave të Komisionit të Pavarur të Mediave, me qëllim të promovimit dhe të zhvillimit të një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale, audiovizuele që u shpërben të gjithë qytetarëve të Republikës sonë.

Hartimi dhe miratimi i projektligjit do të rezultojë me përmbushjen e objektivave për nxitjen dhe mbajtjen e një sistemi të drejtë dhe të hapur për licencim dhe rregullimin e

shërbimeve mediale dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit, në pajtim me standardet e mira evropiane.

Po ashtu në këtë projektligj synohet që të kompletohet infrastruktura ligjore për sigurimin e pavarësisë së punës së KPM-së dhe ngritjen e profesionalizimit të shërbimeve të tyre, duke mbështetur dhe përkrahur gjithmonë lirinë e pavarur të mediave dhe pluralizmin e shërbimeve mediale.

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet e Unionit Evropian.

Ju ftoj që ta miratoni në parim dhe t'i jepni vërejtjet tuaja për miratim në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani hapi debatin lidhur me ligjin.

Sipas radhës së diskutuesve, të paraparë me rregullore, fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, deputeti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se ky projektligj i plotëson të gjitha kushtet e parapara në Rregulloren e Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratimin në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Xhevahire Izma ku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Sot kemi para vetes një ligj të rëndësishëm që do të plotësojë infrastrukturën ligjore më të avancuar në drejtim të përcaktimit të qartë të kompetencave të KPM-së. KPM financohet nga buxheti i Kosovës, por ka edhe vijën e vet ndarëse që i mundëson një punë të pavarur profesionale. Promovimi dhe zhvillimi i një tregu të shëndoshë të shërbimeve audiovizuale, mbajtja e një sistemi të drejtë gjatë licencimit të shërbimeve mediale, rregullimi i frekuencave, pluralizmi medial, janë çështje që adreson ky ligj. Në pjesën më të madhe të kohës gjatë hartimit të këtij ligji kemi marrë pjesë një grup deputetësh nga të gjitha subjektet dhe kemi vërejtur që ky ligj ka pasur hapësirë të madhe për përmirësime, duke diktuar një atmosferë të vështirë bashkëpunimi aty posaçërisht tek operatorët privatë. Pastaj, relacionet në mes të KPM-së, transmetuesit publik dhe krejt në fund Kuvendit dhe KPM-së.

Pasi që grupet e interesit që është shumë normale kanë interferuar në shumë amendamente për ndryshime, mendoj se edhe gjatë fazave të mëtuqeshme ka interesim për pjesëmarrje në grupet punuese.

Unë si anëtare e këtij komisioni ju lus deputetë të nderuar që sa më parë të fillojmë me propozimet konkrete për amendamentimin e tij. Kam një rezervë në njërën nga nenet ku bëhet zhvendosja e tre anëtarëve të Këshillit në ekzekutiv. Konsideroj se kjo zhvendosje sjell implikime buxhetore të cilat assesi nuk do të mund të zgjidhen as me riorganizim të brendshëm dhe në anën tjetër do të ketë përzierje kompetencash me ekzekutivin. Kjo mund të rishikohet gjatë amendamentimit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet në parim edhe ne do të votojmë pro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, e ka fjalën deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuari kryesues,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë,

Edhe ne në Grupin Parlamentar të LDK-së e kemi shqyrtuar projektligjin. Në parim tani e mbështesim, do të jemi aktiv gjatë formimit të grupeve funksionale për ta begatuar akoma. Posaçërisht, pjesa kryesore ku është bërë propozim- ndryshimi që komplet emërtimi tani i komisionit, që më herët ishte emërtuar si këshill, të jetë- të gjitha procedurat e udhëhequra në Kuvend, mendoj se është e qëlluar, ngase më herët ka qenë një konflikt interesi, që ekzekutivi i komisionit e ka propozuar listën e ngushtë, pastaj nga lista e ngushtë është emërtuar kryeshefi që ka qenë një mbyllje e një konfliktit interesi dhe këtë propozim e përshëndesim. Janë edhe disa çështje tjera, që nga vetë emërtimi, pastaj anëtarët e përhershëm të komisionet , që ne do të debatojmë në Komisionin funksional, dhe do të dalim me propozimet konkrete para Kuvendit. Pra, në parim ne e mbështesim.

KRYESUESI: Të faleminderit!

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Alma Lama!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, në përgjithësi është një ligj i punuar mirë, ndryshe nga ligjet të tjera , megjithatë unë disa vërejtje dhe kritika , nëse guxoj të them kritika këtu, s’ na hidhërohet opozita, më fal-pozita, po opozita, shumë shpejt e kam fjalën.

Në lidhje me neni 10, zgjedhja e anëtarëve të KPM-së. Ne ligjin e vjetër, Zyra Ekzekutive e KPM-se ka bërë shpalljen dhe listën e shkurtër për anëtarët e rinj të KPM-se dhe pastaj

e ka dërguar në Kuvend te komisioni ad hoc. Me këtë ligj të ri, Kuvendi i merr të gjitha kompetencat, nga shpallja, bërja e listës së shkurtër dhe aprovimi në komisionin ad hoc. Kjo lë hapësirë për politizimin e KPM-se, sepse dihet që partia e cila e ka numrin më të madh të votave në Kuvend, do të bëjë çmos që t'i fusë njerëzit e vet në KPM.

Unë kisha preferuar që të mbetet versioni i vjetër, ku zyra Ekzekutive e KPM-se, në bashkëpunim me anëtarët e KPM-se, bën shpalljen, listën e shkurtër, kurse roli i Kuvendit është vetëm aprovimi, mirëpo, aprovimi të vijë nga votimi në Kuvend. Ligji i vjetër thotë se Komisioni ad-hoc krijohet nga partitë politike, mirëpo kjo duhet të ndryshojmë, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, ku në bazë të kësaj rregulloreje komisionet krijohen vetëm mbi bazën e grupeve parlamentare. Gjithsesi ne propozojmë që duhet futur mekanizmi i votimit prej 2/3, për të shmangur ndikimin politik. Ose të paktën, nëse mbetet Kuvendi, atëherë të përcaktohet se cili komision e ka për detyrë ta bëjë këtë, pra zgjedhjen. Mirëpo, zgjidhja me e mirë është që Kuvendi të mos merret me procesin e shpalljes dhe bërjes së listës së shkurtër dhe të gjendet një modalitet tjetër.

Në neni 12, mandati i anëtarëve të KPM-së ka mbetur si në versionin e vjetër, por në fakt ky mandat është tepër i shkurtër dhe ne propozojmë që mandati të jetë 3 dhe 4 vjeçar, sepse nga praktika është treguar që një mandati dy vjeçar është mjaftë i shkurtër.

Për sa i përket neni 15 funksionet e Zyrës Ekzekutive, gjuha e përdorur nuk është sensitive nga aspekti gjinor. Duhet që çdo here pas fjalës “kryeshef” të shtohet fjala “kryeshefe” për gjininë femërore. Propozoj gjithashtu që edhe për anëtarët e Bordi të respektohet Ligji për barazi gjinore që është në 40%.

Për sa i përket Bordit të ankesave në ligjin e kaluar, Bordi i ankesave është marrë vetëm me ankesat që për baze e kanë pasur shkeljen procedurale gjatë vendimeve të KPM-se. Kështu si e lexojmë ne, Bordi i Ankesave brenda KPM-së duket se ka marrë fuqi të shfuqizoje çdo vendim të KPM-së. Atëherë nëse është kështu për çfarë shërben Bordi i KPM-së? Pra, ka një alogjizëm në këtë rast dhe propozimi është që Bordi i ankesave, duke pasur parasysh edhe praktikën që nuk ka funksionuar si duhet, të shuhet krejtësisht dhe ankesat për vendimet e KPM-se të shkojnë në Gjykatën Supreme.

Edhe një vërejtje tjetër për ligjin, ai nuk ka marrë parasysh zhvillimin e strategjisë për digjitalizim. Rekomandimi i Grupit ligjor që ka punuar në këtë ligj ka qenë që në dispozitat kalimtare të Ligjit të KPM-së të hyjë një nen që i jep autoritet KPM-se ta zhvillojë këtë strategji dhe ta dorëzojë në Kuvend për miratim. Kjo është shumë rëndësishme, sepse përndryshe strategjia mund të politizohet nga Qeveria, cila do qofte ajo në të ardhmen.

Në një vështrim të përgjithshëm mund të themi se është e qartë që ky ligj e dobëson pavarësinë e KPM-së. Kjo bëhet në dy mënyra duke i dhënë kompetenca Kuvendit duke mos përmendur cili komision në procesin e bërjes së listës së shkurtër dhe gjithashtu duke e bërë Bordin e ankesave me të fortë se vetë Bordi i KPM-së. Pra, nga ana tjetër edhe procesi i digjitalizimit nuk përmendet fare, sidomos kush është bartës i bërjes së strategjisë. Këto janë vërejtjet thelbësore për projektligjin, por duke pasur parasysh që ky

projektligj do të diskutohet në komisionin përkatës, ne kërkojmë që të merren parasysh këto vërejtje dhe për këtë arsye duke shpresuar që do të merren pra parasysh, do ta miratojmë në parim, do ta mbështesim në parim dhe vërejtjet do t'i kalohen komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim Projektligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe sugjerimet e Grupit që do të jepen në Komision do të jenë të bazuara në parimin e promovimit të mediave të lira, demokratike, objektive, të pavarura dhe pluraliste në Kosovë, me të vetmin qëllim të promovimit të një gare të barabartë konkurrense dhe të ndershme në mes të ofertuesve të shërbimeve mediatike në Kosovë, me të vetmin qëllim final interesin publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke përshëndetur ardhjen e projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, për lexim të parë dhe miratim në parim në Kuvend, Koalicioni për Kosovë të Re, ka disa vërejtje në këtë projektligj.

Vërejtjet tona ne do t'i adresojmë edhe në formë të shkruar në komisionin përkatës. Por, së bashku me ju dëshirojmë ta ndajmë shqetësimin për disa nene për të cilat mendojmë se nuk duhet të bëhen kesi lloj ndalesash kur kemi parasysh se jemi duke e ndërtuar një shoqëri demokratike me orientim në Evropën liberale.

Në nenin 11, pika 1.2 anëtarët e KPM-së nuk mund të jenë ish- punonjësit e punësuar në KPM në dy vjetët e fundit. Konsiderojmë se kjo pikë duhet të fshihet për arsye se nuk është në rregull t'u mohohet atyre të cilëve vitet e jetës së tyre i kanë dhënë në këtë institucion.

Neni 21, pika 1.3 gjithashtu konsiderojmë se nuk kemi arsye për frikë dhe nuk duhet të jemi në këtë nivel që të bëjmë ndalesa për marrjen e licencës për televizione private për individin i cili mbanë post të zgjedhur, ose është anëtar i një organi ekzekutiv i një partie politike, për partinë politike ose bashkësinë fetare, kur dihet se ato duhet t'i respektojnë parimet të cilat i përcakton legjislacioni. Në të kundërtën, pra janë sanksionet ose marrja e licencës. Ne konsiderojmë se nuk duhet të bëhet kjo ndalesë, pra, propozojmë që të modifikohet ose të fshihet ky nen.

Neni 29, pika 1.3, gjoha e caktuar maksimale jo më shumë se 100 mijë euro, mendojmë që për t'i mos i rënduar mediat në zhvillimin e tyre profesional dhe logjistikë shuma maksimale e dënimit të jetë 50 mijë euro.

Kemi edhe vërejtje të tjera të cilat do t'i shqyrtojmë së bashku me kolegët tanë në komision.

Të nderuar deputetë,

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, unë pra ju falënderoj për vëmendjen tuaj. Ne Koalicioni për Kosovë të Re, përkrahim në parim këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “6+”, deputeti Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedavajući!

Izvršili smo analizu predloženog Nacrta zakona. Nacrt zakona o javnom emiteru Kosova je u cilju tačnog i brzog informisanja građana Republike Kosovo. Potreba za donošenje ovog zakona sastoji se u regulisanju, uspostavljanju i nadležnosti javnog emitera na Kosovu. Nacrt zakona je u interesu svih građana pošto pruža precizne i objektivne informacije, uz napomenu da u bordovima za javno emitovanje treba da budu i članovi iz manjinskih zajednica.

Nacrt zakona o javnom emiteru Kosova je u saglasnosti i ne krši osnovna načela i politiku Evropske Unije.

Parlamentarna Grupa „6+“ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona o javnom emitovanju na Kosovu. Hvala!

KRYESUESI: Është paraqitur për diskutim, deputetja Blerta Deliu.

BLERTA DELIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni i Pavarur i Mediave ka qenë cak i kritikave të ashpra nga shumë televizione kabllore dhe lokale për siç thonë ata diskriminimin që i është bërë këtij institucioni. Madje, KPM-ja është akuzuar se ka qenë edhe kontrolluar nga disa medime të cilat sipas televizioneve kabllore dhe lokale ka ngulfatur edhe tregun e televizioneve në Kosovë. Prandaj, me ligjin e ri duhet të eliminohet të gjitha mangësitë që i ka prodhuar ligji aktual.

Fillimisht me Ligjin e KPM-së duhet të rregullohet çështja e dhënies së licencave për transmetuesit televiziv në Kosovë. Mendoj se me këtë ligj duhet të parashihet që të gjitha televizionet në Kosovë të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe t'i hyjnë procesit të rilicencimit. Tjetër çështje është se me ligj duhet që gjithë transmetuesit televiziv të trajtohen të barabartë derisa KPM-ja ka ndarë në dy nivele televizionet. Në njërin anë e kemi pasur televizione, kurse në anën tjetër ofrues të shërbimeve programore. Pra, KPM-ja i ka ndarë në televizione të dorës së parë dhe televizione të dorës së dytë, prandaj duhet

që të gjitha ato subjekte që transmetojnë program sipas një skeme programore të quhen televizione.

Çështja e tretë është se KPM-ja duhet t'i obligojë operatorët kabllorë që të fusin në pakon e tyre të gjitha televizionet që marrin licencë nga KPM-ja. Deri më tani kjo nuk ka ndodhur dhe i është lënë mundësia operatorëve kabllorë që të lënë jashtë shumë televizione vendore edhe pse ato i kanë plotësuar kriteret dhe janë pajisur me licencë nga Komisioni i Pavarur i Mediave. Konsideroj se kur KPM-ja vlerëson se një televizion i plotëson kriteret për të transmetuar program dhe e merr licencën, atëherë operatori kabllor duhet të jetë i obliguar që ta fusë në pakon e tij.

Dhe e fundit me këtë ligj duhet të rregullohet që televizionet vendore të kenë përparësi në renditjen e kanaleve për shkak se prodhojnë program vendor me interes për publikun tonë e pastaj të vinë edhe televizione të tjera.

E përkrahi në parim këtë projektligj për procedim të mëtutjeshëm, në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligj të vijën në suaza të kornizës ligjore adekuate vërejtjet, sugjerimet dhe kontributin tonë do ta japim në faza të mëtejme.

**KRYESUESI:** Faleminderit!

S'ka tjerë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk dëshiron fjalën lidhur me këtë ligj. Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Në mbledhje janë prezentë 66 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani: Faleminderit!

Konstatohet se me 61 vota "për", asnjë "kundër" dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

## **2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për partneritet publiko - privat**

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ja ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit, ta prezantoj dhe arsyetoj projektligjin.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** I nderuari zoti nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh kornizën strategjike për procesin e integritetit Evropian të Republikës së Kosovës dhe obligimet e parapara të vendit për afrimin e legjislacionit tonë me atë të BE-së Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur në strategjinë legjislative



për vitin 2011 Ligjin për partneritet publiko-privat dhe koncesione në infrastrukturë dhe procedura për dhënien e tyre. Duke marrë parasysh ndryshimet politike, ekonomike dhe juridike, që kanë ndodhur në vendin tonë që nga koha kur ligji nr.03/L-090 ka hyrë në fuqi në legjisllacionin e BE-së dhe në Raportin e Progresit të vitit 2010, kemi vërejtur që ky ligj ka ndryshime të konsiderueshme nga *acquis communautaire*. Për këtë arsye Ministria e Financave ka draftuar Projektligjin për partneritet publiko-privat, i cili sot ndodhet për shqyrtim. Projektligji është draftuar në përputhje të plotë me: direktivën 2004/17 të Komisionit Evropian për procedurat e prokurimit, direktivën 2004/18 të Komisionit Evropian për dhënien e kontratave dhe dispozitat bazë për financimin privat të infrastrukturës të Qendrës së Kombeve të Bashkuara për Ligjet e Tregtisë Ndërkombëtare. Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i kornizës ligjore për partneritet publiko-privat duke përfshirë procedurat për të hyrë në një partneritet publiko-privat, përmbajtjen dhe strukturën e marrëveshjeve të BBPI-së dhe strukturën institucionale përgjegjëse për menaxhimin dhe zhvillimin e partneritetit publiko-privat në Republikën e Kosovës. Më pas ky ligj do të jetë në harmoni edhe me dispozitat e Projektligjit për prokurimin publik. Përmes këtij ligji do të ndryshohet përbërja e Komisionit Drejtues Ndërmintor për Partneritet Publiko-Privat, në mënyrë që të reflektojë në përbërjen e re të Qeverisë në përputhje me Rregulloren 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive. Departamenti Qëndror për Partneritet Publiko-Privat themelohet në kuadër të Ministrisë së Financave për të ndihmuar dhe këshilluar Komisionin Drejtues Ndërmintor për Partneritetin Publiko-Privat, Ministrinë e Financave dhe autoritetet tjera publike për të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me partneritetin publiko-privat. Përgjegjësia për implementimin e projekteve mbetet me autoritetin kontraktues. Me qëllim të transparencës dhe implikimeve buxhetore që mund t'i kenë projektet që realizohen nëpërmjet partneritetit publiko-privat, është paraparë të gjitha projektet të aprovohen nga Komisioni Drejtues Ndërmintor për Partneritet Publiko-Privat, pra, zbatimit të procedurave të prokurimit si dhe dhënies së kontratave. Ky projektligj është në përputhje me standarde të praktikave më të mira ndërkombëtare, veçanërisht kur janë marrë për bazë direktivat e Bashkimit Evropian që kanë të bëjnë me prokurimin publik dhe dhënien e kontratave që bëjnë një ligj, i cili garanton të gjitha procedurat me transparencë më të madhe.

Të nderuar deputetë, siç e paraqita edhe në fillim të fjalimit tim duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji, propozoj që ta miratoni këtë akt me vlera të veçanta, që rregullon marrëdhëniet në fushën e partneritetit publiko-privat.  
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Tani hapi debatin për diskutim në parim të projektligjit.  
Fjalën e ka kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!  
I nderuari ministër,  
Të nderuar deputetë,

Partneriteti privato-publik është një mënyrë e përshtatshme dhe efikase për nxitjen e investimeve direkt private në zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Me Projektligjin për partneritet privat-publik, krijohet mundësia për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik përmes përfshirjes së sektorit privat në ofrimin e shërbimeve publike dhe të infrastrukturës publike si dhe mundësohet zhvillimi më i shpejtë i infrastrukturës dhe ofrim më efikas i shërbimeve publike për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ndryshimet në Ligjin për partneritet publiko-privat dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre, janë bërë me qëllim të ofrimit të një kornize më të qartë rregullative dhe qartësimin më të mirë të procedurave për implementimin e projekteve për partneritet publiko-privat. Projektligji që na është ofruar për shqyrtim vendos një kornizë të qartë ligjore si dhe përcakton më saktësisht përmbytjen dhe strukturën e marrëveshjeve të partneritetit privat-publik, si dhe vendos një strukturë të përmirësuar institucionale për menaxhimin dhe zhvillimin e partneriteteve privat-publike në Kosovë. Më konkretisht, projektligji ka avancuar dhe harmonizuar tërë konceptin e partnerit privat-publik në pajtim me standardet dhe politikat e Bashkimit Evropian. Në veçanti modelet e partneritetit publiko-privat kontraktues dhe atij institucional janë qartësuar më mirë dhe tani janë më të zbatueshme, si në rrafshin lokal ashtu edhe në atë qendror. Po ashtu, projektligji inkorporon të gjitha dispozitat e direktivave të Bashkësisë Evropiane në lidhje me koncesionet e punës, gjë që ka munguar në ligjin e deritanishëm. Struktura institucionale e Komitetit Ndërmnistror për Partneritetet Publiko-Private është azhurnuar dhe tani pasqyron ndryshimet në përbërjen e Qeverisë. Në aspektin procedural është përmirësuar elementi i mbikëqyrjes për të hyrë në marrëdhënie të partneritetit publiko-privat. Të gjitha transaksionet e partneritetit privato-publik i nënshtrohen shqyrtimit dhe miratimit nga Komiteti Ndërmnistror për Partneritet privato-publik lidhur me implikimet e tyre buxhetore. Fakti që transaksionet mund të ngarkojnë buxhetin në perspektivë afatgjate, përmes hyrjes në obligime financiare të drejtpërdrejta ose të kushtëzuara e bën të domosdoshme mbikëqyrjen e këtyre transaksioneve për të evituar një mbingarkim të buxhetit të autoritetit përkatës ndërkontraktues, gjë që vlen veçanërisht për nivelin komunal.

Po ashtu, Komiteti Ndërmnistror për Partneritet Privato-Publik do të miratojë kontratën, e cila do të lidhet me ofertuesin e përzgjedhur me qëllim që të sigurohet se autoriteti kontraktues nuk do të devijojë nga projekti dhe implikimet buxhetore të miratuara.

projektligji, po ashtu është i harmonizuar edhe me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë, Ligjin për borxhin publik, Projektligjin për ndihma shtetërore si dhe Projektligjin për prokurim publik.

Si rrjedhojë e kësaj, sistemi normative për partneritetin private-publik jo vetëm që është i harmonizuar me standardet dhe politikat e Bashkimit Evropian, por është edhe i sinkronizuar me ligjet tjera të Republikës së Kosovës dhe me këtë janë eliminuar të gjitha kolizionet normative, që deri tani kanë paraqitur problem në interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit për partneritet private-publik. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji për zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe për përfshirjen e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve në infrastrukturën publike, si dhe duke i marrë parasysh avancimet në kuadrin ligjor që sjell me vete ky projektligj, Komisioni për Buxhet dhe

Financa e ka përkrahur në mbledhjen e tij të radhës dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë në lexim të parë.  
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani, përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Hasime Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuari zoti ministër, të nderuar deputetë!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për partneritet publiko-privat dhe në parim e mbështet. Njëherësh kontributin do ta japim nëpër grupet punuese. Po ashtu, ftoj edhe të gjithë deputetët, që nga ana e tyre profesionale të japin kontributin e tyre nëpër grupet punuese.  
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Osmani, më duket, me kartelën e Hashim Deshishkut.

Fjalën e ka Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Partneriteti publiko-privat, qoftë në formë të koncesionit apo në formë të kontratës publike, është forma më e mirë që ndikon në rregullimin dhe zhvillimin e infrastrukturës publike dhe në të gjitha fushat e ekonomisë. Ligji ka një strukturë të mirë dhe dukshëm e përmirëson dhe plotëson ligjin ekzistues, sidomos që ka të bëjë me kohëzgjatjen dhe me përgjegjësitë dhe koordinimin institucional. Edhe pse këtu ka nevojë që më tepër të sqarohen disa dallime dhe përgjegjësi që kanë të bëjnë me nivelin qëndror dhe pushtetin lokal, por, sidoqoftë do të kemi një përqendrim më të madh që të ndikojmë, qoftë si grup punues, i cili është ngritur vetëm në Komisionin për Buxhet dhe Financa, qoftë edhe në komisionin në përgjithësi. Në parim dhe në lexim të parë ligji përkrahet nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe shpresojmë se do të jetë një ligj i mirë dhe i zbatueshëm në përgjithësi.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e përkrah në parim këtë ligj për partneritet publiko-privat, mirëpo i kemi disa vërejtje mjaft substanciale - mendoj unë, të cilat po që se nuk përfshihen në ligj, atëherë nuk mund të garantojë miratim të ligjit në lexim të dytë, për shkak se është një ligj, i cili e mbulon një fushë, e cila është jashtëzakonisht e

rëndësishme në marrëdhënien që shteti e ka me kapitalin privat. Dhe në këtë marrëdhënie të shtetit me kapitalin privat janë dy alternativa ose dy mundësi të rezultateve të cilat dallojnë substancialisht njëra nga tjetra. Përmes partneritetit publiko-privat mund të përfshihet kapitali privat për ta ndihmuar shtetin në aspekte të caktuara të ofrimit të ndonjë shërbimi apo ndërtimit të infrastrukturës për të mirën publike, mirëpo, shumë lehtë mund të ndodhë kjo tjetra, e cila ndodhë zakonisht në shumë shtete nëpër botë, që gradualisht pronësia publike kalohet në pronësi private dhe të mirat publike i kalojnë kapitalit privat pa kurrfarë dëmshpërblimi. Pra, kjo është një mundësi shumë e rrezikshme – konsiderojmë ne, e hyrjes në marrëveshje ose kontrata të partneritetit publiko-privat. Në këtë drejtim vërejtjet tona fillestare përqendrohen në katër çështje kryesore që i mbulon ky ligj, të cilat janë tejet të rëndësishme – mendoj unë – për ligjin, duke mos e anashkaluar rëndësinë e aspekteve tjera, që i mbulon ky ligj.

Çështja e parë është te fushëveprimi. Fushëveprimi lidhet drejtpërsëdrejti me këtë që e thashë më parë. Pra, konsideroj që fushëveprimi i këtij ligji është i zgjeruar jashtë mase dhe nuk duhet të jetë kaq i gjerë. Pra, nuk duhet që të lejojmë partneritet as publiko-privat e as kurrfarë koncesioni në disa aspekte që mbulohen me këtë ligj, e të cilat janë – kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me mirëqenien e qytetarëve të Kosovës. P.sh. po i marr vetëm dy shembuj, e ka edhe të tjerë, këtu shihet që të përfshihet kapitali privat edhe në furnizimin me ujë, gjë që e konsideroj që nuk duhet të lejohet për shkak se e dimë që uji është i një rëndësie të jashtëzakonshme për, jo vetëm mirëqenien, por edhe mbijetesën e qytetarëve dhe nëse këtë ja lëmë në duar kapitalit privat, atëherë shumë lehtë do të vijmë në një situatë kur qytetarët nuk do ta kenë mundësinë që ta mbulojnë faturën e vet të furnizimit me ujë, gjë që ka ndodhur në disa shtete nëpër botë. Këtu mund ta përmend vetëm Bolivinë, ta zëmë. Pastaj, është edhe çështja e infrastrukturës së burgjeve. Pra, kjo është edhe një tendencë e tërheqjes graduale të shtetit nga ato që janë konsideruar tradicionalisht si role të shtetit në ofrimin e shërbimeve publike dhe në përkujdesjen ndaj qytetarëve, dhe kjo tërheqje e shtetit – konsiderojmë ne - është e dëmshme, për shkak se atëherë kjo logjikë do të na dërgojë gradualisht edhe drejt privatizimit të Qeverisë, pra privatizimi i çdo gjeje publike, nënkupton edhe privatizim të shtetit në njëfarë mënyre, gjë që ka rrezik të ndodhë e që në disa raste kam drojën që po ndodhë në Kosovë për të keq.

Çështja e dytë është çështja e pronësisë përmbi asetet publike, të cilat parashihen të mbulohen me këtë ligj, dhe konsideroj që ligji në këtë aspekt është mjaft i kujdesur në disa fusha për ta rregulluar këtë fushë për të mirë të publikut. Pra, nuk lejon që këto asete publike të kalojnë në pronësi private edhe me kontratë dhe nuk lejon që këto asete të përdoren si lloj pengu, apo lloj mjeti të siguresës në çfarëdo kontrate, gjë që është e mirë, pra që është një lloj mbrojtje e aseteve publike nga ligji.

Çështja e tretë që lidhet edhe me çështjen e parë është të drejtat financiare. Këtu thuhet që partneri privat ka të drejtë të vendosë, pranojë ose mbledhë tarifa ose pagesa për shfrytëzimin e infrastrukturës publike, ose ofrimin e shërbimeve publike në përputhje me kushtet e përcaktuara me marrëveshje. Konsideroj që këtu duhet të jemi më të kujdesshëm dhe ta përcaktojmë me ligj se duhet të ketë një lloj si të them tavani të çmimeve që mund t'i vendosë kapitali privat, pra jo vetëm përmes marrëveshjes, për

shkak se nëse ia lëmë vetëm marrëveshjes këtë gjë atëherë këtë të drejtë po ia delegojmë në njëfarë mënyre arbitraritetit të Qeverisë, arbitraritetit të autoritetit, i cili merret me përpilimin e kontratës. Dhe, konsideroj që ne si Kuvend duhet që të jemi të kujdesshëm që këtë çështje t'ia lëmë një autoriteti të pavarur që ta vendosë këtë dhe jo ta kalojmë në këtë mundësi të keqpërdorimit të këtyre tarifave, apo thjeshtë që kapitali privat të përcaktojë tarifa shumë të larta të papërbalueshme për qytetarët, dhe çështja e katërt është te ndihma shtetërore.

Këtu vetëm shkurtimisht do të isha ndalur në këtë. Pra, këtu thuhet që edhe në partneritetin publiko-privat lejohet ndihma shtetërore. Dhe, kjo mendoj që është në kundërshtim me logjikën e partneritetit publiko-privat, për shkak se logjika e partneritetit publiko-privat është që ta mobilizojmë kapitalin privat për ta ndihmuar një çështje infrastrukturore, apo të shërbimit publik. Dhe, nëse kjo është logjika, atëherë ku ka logjikë që edhe në raste të tilla shteti prapë të marrë pjesë me kapitalin e vet, atëherë kjo po shkon në kundërshtim me logjikën. Po që se shteti i ka paratë për një shërbim apo infrastrukturë atëherë pse na nevojitet kapitali privat, dhe pse ta ndihmojmë ne me ndihmë shtetërore kapitalin privat për një gjë të cilën duhet ta ofrojë shteti?

Këto janë katër prej vërejtjeve të them fillestare të Lëvizjes “Vetëvendosje”, për këtë ligj, dhe natyrisht që ne do të jemi të angazhuar në komisione përkatëse për ta rregulluar këtë ligj, pra, për ta kthyer këtë ligj në ato aspekte ku ky nuk është në të mirën e publikut dhe në shërbim të publikut.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Kolegë deputetë, përfaqësues të Qeverisë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e konsideron si mjaft të rëndësishëm Ligjin për partneritet publiko-privat, sidomos për faktin që lidhet me reformat që duhen bërë në ekonomi, respektivisht për përfshirjen e sektorit privat në infrastrukturë dhe shërbime publike. Mirëpo, përveç asaj se çka e prezantoi ministri, do të thotë qëllimit të ndryshimeve, të cilat janë bërë kryesisht për ta përafruar Ligjin me direktivat e Unionit Evropian, ne kërkojmë nga Qeveria, që prej leximit të parë, në të dytin, të përfshijë edhe komunitetin e biznesit në grupet punuese dhe debatet me qëllim të qartësimit që do të fuqizojnë përfshirjen e sektorit privat në infrastrukturë dhe shërbime publike. Duke thjeshtësuar metodën, punën dhe me qëllim të krijimit të lehtësirave legjislative, me qëllim të rritjes së atraktivitetit për investitorët potencial, sepse nga përvojat tona do të thotë edhe gatishmëria eventuale e investitorëve potencialë ka hasur në ngecje për shkak të procedurave burokratike, që janë lidhur me legjislacionin në fuqi.

Ju faleminderit, në parim e përkrahim!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për ministrin dhe gjithë deputetët e kësaj seance,

Duke marrë parasysh se Projektligji për partneritet publiko-privat ka qenë edhe në legjislacionin e kaluar dhe është punuar mjaftë në këtë projektligj, mirëpo në bazë të deklaramit të ministrit dhe në bazë të projektligjit i cili është para nesh shihet që në këtë projektligj janë paraparë edhe disa direktiva të BE-së që të harmonizohet me direktiva të BE-së. Mund të themi se ligji është i rëndësishë më të veçantë për arsye se buxheti i Kosovës nuk është aq buxhet i madh për investime në infrastrukturë dhe në shërbime publike dhe mundëson që çdo investitor të ketë edhe infrastrukturën ligjore të plotësuar me të cilën mund të parashihet edhe profitin e tij në investimet që mund t'i bëjnë në shtetin tonë.

Duke marrë parasysh rëndësinë e projektligjit mund të themi se kemi disa vërejtje të vogla mirëpo sipas të gjitha gjasave diku te nenin 16, atëherë këto vërejtjet do të parashihen në Komisionin parlamentar. Në parim Koalicioni për Kosovë të Re do t'i japë përkrahje këtij ligji për arsye se i duhet mjaftë shumë shtetit tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar "6+", deputetja Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem, predsedavajući!

Pozdrav za ministre!

Mišljenje Parlamentarne grupe „6+“ po pitanju Nacrta zakona o javnom privatnom partnerstvu je vrlo pozitivno jer za cilj ima stvaranje adekvatnog pravnog okvira za javno privatno partnerstvo, sadržaj i strukturu sporazuma za javno privatno partnerstvo, institucionalne infrastrukture, odgovorne za upravljanje i razvoj ovakvog partnerstva.

Ovaj Nacrt zakona reguliše javno privatno partnerstvo u pružanju javnih usluga i javne infrastrukture svim ekonomskim i društvenim sektorima gde spadaju prijevozu, energetika, infrastruktura, razvoj vode, crne vode, otpada, telekomunikacije, obrazovanje i drugo.

Nacrt zakona nema dodatne budžetske implikacije, tako da neće opterećivati postojeće budžetsko stanje, a mogući budžetski troškovi će... u okviru tekućeg budžeta.

Parlamentarna grupa „6+“, glasaće za ovaj Nacrt zakona. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit!

Për fjalë është paraqitur deputetja Pula.

JUSTINA PULA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministër, deputetë,

Unë do t'i them disa komente të mia rreth Projektligjit për partneritetin projekto privat. Ky projektligj është shumë me rëndësi sa i përket jo vetëm tërheqjen e investimeve, por

thjeshtë zhvillimin e disa degëve të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe unë kështu mendoj që mund të avancojmë edhe projekte të ndryshme.

Çështja e parë të cilën dëshiroj ta cekim është se në këtë draftligj për partneritet publiko-privat neni 2, paragrafi 1 dhe 2, përjashtohet gjenerimi i energjisë dhe kështu krijohet vakum ligjor për partneritet publik privat në gjenerim. Konkretisht Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, neni 39, paragrafi 5 thotë: “të gjitha procedurat e tenderimit do të projektohen në bazë të kriterëve objektivave transparente dhe jo diskriminuese dhe do të ushtrohen në përputhje të plotë me dispozitat aplikueshme të Ligjit për partneritet publik-privat. Por draftligji i ri për partneritet publik- privat nuk zbatohet për gjenerimin e energjisë elektrike. Bëhet pyetja, cilin ligj do ta pranojmë dhe pse duhet të ketë konflikte apo kontradikta mes ligjeve?

Nën dy, me qenka ky ligj është përjashtuar gjenerimi i energjisë elektrike apo gjenerimi i energjisë, projekti Kosova e Re duhet të përcaktohet se cili është ai ligj i cili do ta përcjellë këtë projekt dhe në bazë të cilit ligj do të vazhdojnë procedurat e tenderit dhe zbatimit të këtij ligji? Bëhet pyetje: nëse ky është një projekt i partneritetit dhe nëse projekti Kosova e Re ka të bëjë me partneritet dhe këtu nuk është paraparë me partneritet, atëherë me cilin ligj do të vazhdojë?

Unë e di ministër se ju sa i përket Ligjit të partneritetit nuk jeni direkt i lidhur me këtë por unë mendoj që Ministri i Zhvillimit Ekonomik duhet të jetë shumë i brengosur nëse në Ligjin e partneritetit nuk janë paraparë procedurat dhe zhvillimi i projektit Kosova e Re, për shkak se ajo është në krye të komitetit drejtues.

Prandaj, dëshiroj dhe mendoj që duhet të precizohet cilat janë projektet strategjike energjetike të cilat parashikohen me partneritet dhe nëse nuk parashikohet cili është ai ligj apo në mënyrë të shpejtë duhet të planifikojmë apo të dizajnojmë një ligj të ri.

Në këtë draftligj të partneritetit përjashtohet mihja e linjtit dhe kështu krijohet vakum ligjor i partneritetit. Konkretisht Ligji për miniera dhe minerale, neni 19 pika 1.3 me titull: “Kushtet themelore të procedurës konkurruese për dhënien e licencave parasheh se procedura tenderuese do të ushtrohet në përputhje të plotë me kërkesat procedurale të Ligjit mbi partneritetin dhënie me koncesion.

Tani nuk ekziston ky ligj, cili është ai ligj, të cilën do të shfrytëzojnë mihjen e Sibovcit apo mihje të tjera në Kosovë?

Sa i përket gjenerimit të energjisë nga uji i bëhet pyetje ministër apo ministrisë përkatëse. A është e mundur se dhënia me koncesione e ujit duhet të jetë pjesë e ligjit që mbulon koncesionin? A është menduar se kjo do të mbulohet me ligjin e Zyrës së Rregullatorit, por nuk është e arsyeshme, sepse Ligji i Zyrës së Rregullatorit nuk mund të trajtojë koncesionin e burimeve natyrore.

Prodhimi i energjisë elektrike nga uji mbulohet me Ligjin e ujërave, por atje nuk shënohen qartë procedurat e koncesionimit, edhe pse ligji përcakton qartë se dhënia e

ujërave në shfrytëzim për prodhimin e energjisë elektrike bëhet me tender të hapur. Prandaj, procedurat e ligjit të ri të partneritetit duhet të mbulojnë edhe ujërat sa i përket zhvillimit të kapaciteteve gjeneruese.

Do ishte përgjegjshme dhe kundërligjshme që të mendohet se koncesioni sidomos për hidrocentrale të mëdha të cilat janë strategjike për Kosovën të jepen pa tender, ose duhet të definohet qartë dhe saktë se cilat kapacitete të hidrocentraleve të jepen me tender apo cilat kapacitete do të duhen të afrohen procedurës së autorizimit nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Domethënë duhet të përcaktohet me këtë ligj çka i takon Zyrës së Rregullatorit dhe çka i takon procedurës së partneritetit?

Dhe, një pikë tjetër me rëndësi. Sipas koncesionimit të këtij draftligji të ri të partneritetit duhet të hiqet prej tij edhe gazsjellësi, sepse edhe këtu mbulohet nga ligji i Zyrës së Rregullatorit. Domethënë disa sektorë të energjisë janë dhënë si prioritet Zyrës së Rregullatorit, ndërsa disa iu kanë dhënë Ligjit të partneritetit. Çdo gjë që ka të bëjë me sektorin e energjisë, ose duhet të përfshihet në këtë ligj të partneritetit ose në fakt duhet me Ligjin e energjisë apo pakon të ligjeve të energjisë të bartë të Zyra e Rregullatorit. Mirëpo, duhet të definohen qartë mos të ketë vakum ligjor dhe mos të ketë dilema se me cilin ligj të bazohemi. Ju faleminderit!

**KRYETUESI:** Faleminderit, zonja deputete!

Nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë, nëse dëshiron? Nuk dëshiron.

Në vazhdim, kërkojmë deklarinimin me votim për miratimin në parim të Projektligjit për partneritet publiko - privat.

Në sallë janë 72 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Faleminderit!

Konstatohet se me 71 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për partneritet publiko - privat.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, që është:

### **3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transmetim publik në Kosovë**

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ja ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj zotin ministër Hamza, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantoj dhe arsyetoj projektligjin.



MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari zoti nënkryetar,  
Deputetë të nderuar,  
Në këtë seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, para jush paraqes Projektligjin për transmetimin publik të Kosovës.

Projektligji për transmetimin publik të Kosovës është miratuar nga Qeveria me vendim numër 04/21 të datës 29.6.2011.

Nevoja për nxjerrjen e këtij ligji konsiston në gatishmërinë e Qeverisë, në rregullimin, themelimin, funksionimin dhe kompetencat e transmetuesit publik të Kosovës si dhe gjetjen e financimit të qëndrueshëm të Radio Televizionit të Kosovës me qëllim të sigurimit të informimit të saktë objektivë të paanshëm dhe të shpejtë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Hartimi dhe miratimi i projektligjit do të rezultojë me përmbushjen e obligimeve të caktuara në ndërlidhje me pakon e Ahtisarit, aneksi 2, neni 3, pika j) dhe neni 3, pika k) të propozimi gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës si dhe raportin e progresit për Kosovën. Projektligji për transmetimin publik të Kosovës, e ka një sistematizim të mirëfilltë të materies të cilën e mbulon, zgjidhje adruake sa i përket fushës të cilën e mbulon dhe krijon një infrastrukturë ligjore më të avancuar.

Projektligji për transmetimin publik të Kosovës, është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe është më përputhje të plotë me kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet e Bashkimit Evropian.

Kam nderin që pata rastin t'ju informoj në pika të shkurta në përmbajtjen e këtij projektligji dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni, në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligj, të vihen në suazat e kornizës ligjore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Hapim debatin për diskutim në parim të projektligjit.

Sipas radhës fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Qeverisje Lokale dhe Media, deputeti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit zoti nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional përkatës, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik të vitit 2011, shqyrtoi në parim Projektligjin për transmetuesin publik në Kosovë dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

## REKOMANDIM

Të miratohet në parim Projektligji për transmetuesin publik në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka Xhevahire Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Para vetes kemi pra sot një ligj shumë të rëndësishëm, Ligjin për transmetuesin publik në Kosovë. Funksionimi i mirë dhe i qëndrueshëm i transmetuesit publik, është një ndër standardet qenësore të zhvillimit dhe fuqizimit të demokracisë. Si anëtare dhe kryesuese e këtij ligji, marrë të drejtën të paraqes vërejtjet e mia substanciale në këto pika. RTK, është transmetues publik dhe duhet të mbrojë interesin e publikut, në radhë të parë e pastaj edhe të sferës së gjithmbarshme të mediave në Kosovë.

Kuvendi si themelues i transmetuesit publik, siguron financim adekuat për realizimin e misionit të RTK-së, dhe në këtë pikë duke u përshtatur me legjislacionin e BE-së, Kuvendi duhet të sigurojë këtë financim aq sa nuk dëmton operatorët e tjerë medial në vend dhe nuk cenon konkurrencën e ndershme.

Të nderuar kolegë deputetë,

Para hartimit të këtij ligji, janë organizuar disa tryeza dhe grupe punuese me ekspertë, grupe, interesa dhe aktorë që kanë njohuri, përvoja dhe eksperiencë me këtë ligj. Mirëpo, ne si komision do të kemi mundësi t'i plotësojmë të gjitha mungesat si grupe parlamentare, ndërsa me juve tani dua ta ndaj një shqetësim.

Duke u nisur nga fakti se RTK po përballet me vështirësi financiare dhe e ka mjaftë të vështirë të mbajë kanalin aktual, përfshirja në këtë ligj e një kanali të ri televiziv në gjuhën serbe e komplikon funksionalitetin e transmetuesit publik, sidomos në aspektin financiar. Nëse RTK e merr përgjegjësinë për këtë kanal, atëherë RTK duhet që nga fillimi ta formojë edhe një kanal që nënkupton punësimi e një numri të konsiderueshëm të punëtorëve, menaxhmentit të ri programor, teknologjisë complete të re, hapësirave të reja, komplet logjistike pra e re dhe të gjitha këto kanë një kosto shumë të lartë financiare.

Problemi tjetër qëndron edhe tek mungesa e frekuencave që është një problem tjetër akoma i diskutueshëm dhe problem edhe politik. Konsideroj se kanali televiziv në gjuhën serbe, duhet të hiqet nga Ligji për transmetuesin publik, respektivisht Radiotelevizionin e Kosovës.

Vërejtjet tjera do t'i japim në vazhdim në punën gjatë amendamentimit, ndërsa sot Grupi Parlamentar i PDK-së, e mbështet dhe do të votoj pro. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar i LDK-së, deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Dhe, në Grupin Parlamentar të LDK-së, pas shqyrtimit të këtij projektligji, e konsiderojmë që ky projektligj ka ambicie të rëndësishme që lidhen me vetë

transmetuesin publik dhe kërkojmë që t'i jepet një kohë e mjaftueshme grupit i cili do të formohet në trajtimin e mëtejshëm të këtij ligji. Sidomos që nga vetë titullimi i ligjit, pastaj çështja e pronësisë së ish-transmetuesit të RTK-së, pra Radiotelevizionit të Prishtinës ose të Kosovës, pastaj çështja e kanalit të dytë, çështja e financimit, janë çështje për të cilat ka dilema dhe mund të ngrihen në çdo moment alternativa se cila është forma më e mirë e organizimit. Prandaj, duke dashur ta kursej kohën, në emër të Grupit Parlamentar, ne do të bashkëpunojmë me grupet që do të ndërtohen dhe do t'i kontribuojnë punës së mëtejme në procedimin e këtij ligji, ndërsa sot parimisht e përkrahim të njëjtin.

**KRYESUESI:** Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Alma Lama.

**ALMA LAMA:** Faleminderit, zoti kryesues!

Në një shoqëri demokratike, legjislacioni për median duhet të bazohet në mundësinë e lirisë, përfshirë të drejtat dhe liritë e shënuara në nenin 19 të Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave Civile dhe Politike, si dhe në nenin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Edhe në nenin 6 të Traktatit të Bashkimit Evropian mbështet kjo filozofi. Për sa i përket standardeve evropiane për transmetuesit publikë, ato janë të definuara nga kriteret e Kopenhagës. Traktati nuk e paracakton mënyrën e financimit të mediave publike, pra nëpërmjet parapagimit, reklamave apo ndonjë subvencionimi të publikut, sa kohë që një financim i tillë jepet për t'i përmbushur nevojat e publikut dhe nuk ndikon në pavarësinë editoriale dhe në situatën e konkurrencës mediatike në vendin përkatës.

Ne këtë frymë duhet të jetë edhe Ligji për transmetuesin publik, që e kemi para vetes. Që në fillim, do të thosha se parimet kryesore për transmetuesin publik janë përfshirë në këtë ligj dhe synohen të ruhen nëpërmjet tij. Pavarësia editoriale mbetet parimi themelor, i cili duhet të garantohet.

Unë nuk e shoh aspak si pozitiv faktin që ky ligj është përgatitur nga Qeveria, ai është dashur të përgatitet nga Kuvendi, si themelues i RTK-së, madje e shoh si anomali, mirëpo shpresoj se vërejtjet e deputetëve do të merren parasysh.

Për sa i përket financimit, mendoj se janë të drejta mënyrat që janë zgjedhur në ligj, mirëpo duhet të specifikohen më tej. Ne propozojmë që Kuvendi i Kosovës të ndajë buxhet për disa programe të cilat nuk e cenojnë pavarësinë editoriale, e këto janë: sporti, programet për fëmijë, programet arsimore dhe shkencore, si dhe programet për minoritetet dhe për diasporën mund të financohen nga Buxheti i Kosovës. Mirëpo, ky buxhet, me propozim të Bordit të RTK-së, pas një planifikimi të mirë, duhet të miratohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit dhe jo nga Qeveria.

Gjithashtu, në ligj duhet të sanksionohet se destinacioni i këtij buxheti nuk mund të ndryshojë, pra paratë nuk mund të përdoren për programe apo aktivitete të tjera të RTK-së.

RTK mund të financohet nga aktivitete komerciale brenda një limiti të caktuar, megjithatë këto aktivitete duhet të jenë të ndara nga ato që lidhen me servisin publik dhe nuk mund të subvencionohen dyfish nga fondet publike.

Ne ligj thuhet se niveli i shumës së parapaguar duhet të jetë në përputhje me indeksin e kostos. Në ligj duhet të thuhet se niveli i shumës së parapaguar, pra kur të vijmë tek parapagimi, përcaktimi i shumës së parapaguar, duhet të jetë në përputhje me indeksin e kostos së jetesës. Çfarëdo ndryshimi i kësaj shume duhet të lajmërohet çdo 1 shtatori të çdo viti, për vitin tjetër pasardhës. Në ligj duhet të specifikohet që programet për diasporën duhet të financohen nga buxheti i Kuvendit dhe jo nga shikuesit apo dëgjuesit brenda territorit të Kosovës, pasi ata nuk marrin asgjë si kundërshtpërblim.

Për sa i përket drejtorit të përgjithshëm, duhet të shtohet në këtë ligj që tek mënyra e raportimit, po flasim, kur gjenden parregullsi, Bordi mbikëqyrës instrukton drejtorin e përgjithshëm që t'i eliminojë ato parregullsi dhe të sigurojë që ato nuk do të përsëriten më.

Po kështu, në nenin 34, thuhet se drejtori i përgjithshëm duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës. Unë propozoj të hiqet ky kufizim, pasi nuk kemi të bëjmë as me punonjës të administratës, as me ndonjë diplomat. Përkundrazi, emërimi i ndonjë profesionisti që mund të vijë nga jashtë, siç ka qenë rasti me RTK, kur në fillim drejtor ka qenë një gazetar i BBC-së, do të ishte një gjetje shumë e mirë, është një praktikë që e kanë edhe vendet tjera të rajonit.

Tek neni 24, pika 10, thuhet se gjykata kompetente obligohet që rastet e mos pagesës, respektivisht mos pagesës së rregullt të parapagimit të RTK-së t'i trajtojë me përparësi dhe urgjencë. Po i marr nenet sipas radhës.

Çështja është se kush mund ta obligojë gjykatën për një gjë të tillë, kur gjyqësori është i pavarur. Nga ana tjetër, ka edhe çështje urgjente, shumë më urgjente për gjykatat, siç janë: krimet e rënda, vrasjet e të tjerë, kështu që nuk mendoj që ky është një mekanizëm që do të funksionojë.

Për sa i përket Bordit të RTK-së, më duket se në këtë projektligj, ashtu sikurse edhe në Projektligjin për KPM, ka një tentativë për të zbehur rolin e tyre.

Procedurat e zgjedhjes nuk janë të qarta në këtë ligj dhe unë propozoj që ato të merren nga ligji i kaluar.

Mirëpo, kur vijmë tek votimi, mendoj se është më rëndësi të përforcojmë ruajtjen e pavarësisë editoriale nga ndikimet politike. Ne propozojmë që emërimi i anëtarëve të Bordit të bëhet me 2/3 e Kuvendit, ose me shumicë të kualifikuar, në mënyrë që të

reduktohet risku i ndërhyrjeve politike dhe ato figura të cilat do të bëhen anëtarë të Bordit, të jenë më të pranueshme dhe konsensuale

Gjithashtu, propozoj që kur ata konkurrojnë, të nënshkruajnë një deklaratë se të gjitha informatat e tyre janë të vërteta dhe se nuk kanë të bëjnë me ndonjë subjekt politik. Po kështu, përpara se ata të zgjidhen përfundimisht, duhet t'i nënshtrohen një debati publik, i cili do të shoshiste personalitetin e tyre.

Mendoj se do të ishte mirë që në bord të bënte pjesë edhe një përfaqësues i Akademisë së Shkencave.

Në përbërjen e Bordit mendoj se duhet të jenë dy pjesëtarë të minoriteve dhe jo tre, siç thuhet në ligj. Tashmë janë 11 anëtarë të Bordit, nga 9 që kanë qenë më përpara. Duhet, gjithashtu, të respektohet Ligji për barazi gjinore, ku së paku 4 anëtarë të bordit të jenë të gjinisë tjetër.

Ligji për barazi gjinore duhet, gjithashtu, të respektohet edhe në menaxhmentin e RTK-së, pasi kemi të bëjmë me një institucion publik. Kur vijmë tek zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm, mendojmë gjithashtu që duhet të zgjidhet me 2/3 e votave të anëtarëve të bordit, në mënyrë që të mos lihet hapësira për anime politike, pra. Gjithashtu, duhet që në ligj, tek nenet që kanë të bëjnë me drejtorin e përgjithshëm, me punën e tij, duhet që të përfshihet një nen i veçantë, diskutimet dhe komentet e bëra nga shikuesit, pra ato duhet të merren parasysh në përcaktimin e linjave programore dhe në rastet kur arsyetohet, instruktohet drejtori i përgjithshëm që t'i prezantojë këto ndryshime, në programin e RTK-së.

Në nenin 30, tek shkarkimi dhe dorëheqja e bordit, ne propozojmë që të futet si arsye për shkarkim, që të shtohet si arsye për shkarkim edhe mosmiratimi i raportit të punës nga ana e Kuvendit, në rast se kjo ndodh për dy vjet radhazi. Kur jemi këtu, mendoj që të gjitha institucionet, faktikisht të pavarura publike, do të duhej që të harmonizohet kjo, në rast se raportet e punës nuk miratohen nga Kuvendi dhe duke pasur parasysh se ne duam që ta forcojmë rolin mbikëqyrës të Kuvendit, mendoj se duhet të ketë një masë, jo kështu siç po ndodhë tani që raportet kalojnë dhe nuk kalojnë dhe asgjë nuk ndodhë në realitet. Këto janë praktika që i kanë vendet më të zhvilluara, janë praktika shumë demokratike, të cilat e rrisin efikasitetin e punës dhe transparencës.

Gjithashtu, në këtë projektligj duhet të shtohet një pikë se mbledhjet e Bordit të RTK-së, pra janë transparente për publikun, përveçse kur diskutohen raste të ndjeshme që kanë të bëjnë me të dhëna konfidenciale apo ruajtje të privatësisë.

Për sa i përket gjuhës së përdorur, si në aspektin juridik, ku shpjegohen konceptet, ashtu edhe në sintaksë, shumë shpesh është e pakuptueshme dhe ka shumë përsëritje.

Vërejtja e parë vjen për titullin e projektligjit. Ai duhet të quhet: "Projektligji për transmetuesin publik", jo për transmetimin, sepse transmetimi nënkupton procesin dhe ligji është për RTK-në.

Në nenin 2, 1.4 duhet të shtohet togfjalëshi: “i themeluar nga Kuvendi”. I njëjti nen, pika 1.9, veprat audovizuele evropiane, duket pa kuptim dhe duhen konsultuar punuesit e ligjit për se e kanë fjalën, pasi as në variantin anglisht nuk merret vesh.

Neni 4, pika 2, duhet të shtohet: “Garantimi i pavarësisë editoriale” dhe të shkruhet në këtë mënyrë: “Është detyrë e themeluesit të garantojë autonominë institucionale dhe pavarësinë editoriale të RTK-së dhe të sigurojë financim adekuat për zbatimin e misionit të servisit publik”

Neni 6, pasuria e transmetuesit publik, është e paqartë kur thotë, ndër të tjera, se “përbëhet nga tërë pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme e fituar me kohë nga puna dhe aktivitetet e punonjësve të transmetuesit publik”. Pra, kjo mund të interpretohet se puna e punëtorëve i përket RTK-së, si pasuri, dhe jo vetë atyre, është krejtësisht e paqartë kjo.

Te po ky nen, pika 4, thuhet se “Transmetuesi publik është trashëgimtar i RTK-së”. Në rast se do të mbetet kështu, atëherë RTK duhet të marrë përsipër edhe obligimet për punëtorët e RTK-së, më falni, të televizionit të vjetër.

Tek parimet programore të transmetuesit publik, neni 4, propozojmë të rishkruhet në këtë mënyrë. “RTK siguron informim të paanshëm, adekuat dhe gjithëpërfshirës, me interes për publikun, duke afirmuar qasjen, qëndrimin dhe trajtimin kreativ ndaj të gjithëve dhe për të gjithë, pa dallim”.

Këtu duhet të futet një pikë e veçante për barazinë gjinore dhe propozojmë të formulohet në këtë mënyrë: “RTK duhet të paraqesë në mënyrë të balancuar dhe pa stereotipe punën dhe aktivitetet e të dyja gjinive në të gjitha programet e tij.”

Neni 8 bien në përsëritje me nenin 7, kur flet për parimet programore të transmetuesit publik, ndaj propozojmë që të fshihen ato pika ku ka përsëritje dhe të tjerat të merren dhe të vendosen tek neni 7. Titulli i këtij neni duhet të mbetet, vetëm “përbërja dhe skemat programore të transmetuesit publik”.

Tek neni 7, pika 5, kur përcaktohen veprimtaritë kryesore, duhet të fshihet pjesa “prodhimi e distribuimi i Produksionit Muzikor - Argëtues, pasi kjo nuk është veprimtari kryesore e transmetuesit publik.

Tek numri i kanaleve, do të propozojmë së paku 3 kanale, pasi njëri prej tyre në propozojmë që të jetë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdoni, edhe 2 minuta!

VAZHDIM, ALMA LAMA: ... RTK Parlamenti, të cilin do ta shpjegoj pak më vonë. Besoj se është kjo iniciativë edhe e grupeve të tjera parlamentare, ku procedurat se si do

të funksionojë, ne i kemi shqyrtuar disa mënyra se si i kanë vendet e ndryshme, por do t'i propozoj me shkrim, meqë nuk kemi kohë tani t'i lexojmë.

Për sa i përket financimit të kanalit të Parlamentit, mendoj se duhet të jetë obligim i Kuvendit për ta financuar atë, mirëpo procedurat e mëtutjeshme i dërgojmë me shkrim në komision, ndërsa sa i përket kanalit për minoritete, gjithashtu pajtohemi që duke pasur parasysh krizën financiare të RTK-së, nuk është momenti i duhur për të ngritur një kanal vetëm për serbët dhe, për më tepër, është e papranueshme kërkesa që ai të ngrihet në ndërtesa të veçanta në Graçanicë e tjerë. Në rast se është pjesë e Televizionit publik, ai duhet të jetë në të njëjtën ndërtesë. Por, gjithsesi në këtë situatë nuk mendoj se është zgjidhja më adekuate.

Unë kam edhe shumë pika të tjera të ligjit, por i dorëzoj me shkrim. Kaq kisha. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Teuta Haxhiu.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për transmetimin publik të Kosovës, të cilën ne e kemi sot në duar, konsiderojmë se është një ndër projektligjet e rëndësishme që ky Kuvend ka për detyrë ta shqyrtojë dhe elaborojë me qëllim të sigurimit të informacionit të saktë, objektiv, të paanshëm dhe të shpejtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ne sot më shumë se kurrë kemi nevojë për fjalën e lirë në media, sepse një gjë e tillë është në funksion të përparimit dhe transparencës për të cilën do të duhej të angazhohemi të gjithë. Ne, si Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, do ta përkrahim në parim, do të mundohemi shumë shkurt t'i japim disa sugjerime për të vazhdat pastaj në grupin funksional.

Mendojmë se duhet të gjendet një mënyrë e financimit që do të krijonte një medium komplet të pavarur. Po i përmend vetëm te neni 23, pothuaj në të gjitha pikat shpjegon burimet e financimit të RTK-së, një periudhë tranzitore deri 3 vjeçare, deri në sigurimin e financimit nga parapagimi. Çdo vit RTK-së i ndahen 0.7% të hyra nga buxheti i Kosovës, duke përjashtuar atë hyrat nga procesi i privatizimit, të hyrat e njëhershme për buxhetin e Kosovës dhe të hyrat vetjake në nivelin qendror dhe lokal.

Ne mendojmë se nuk duhet të jetë një periudhë 3 vjeçare. Kjo mënyrë e zgjedhjes duhet të bëhet së paku për 5 vjet, e pse jo edhe të mbetet e hapur. Jetëgjatësia e kësaj mënyre të financimit, ne konsiderojmë se, nëse ndërkohë krijohen rrethanat e reja dhe besohet se ato do të jenë të dobishme, atëherë merret iniciativa dhe bëhen ndryshimet e aspiruara. Kjo edhe për faktin se 3 vjet janë shumë pak, sepse kjo i bie që shumë shpejt sërish t'i hyhet plotësim- ndryshimit nga se procedurat deri te gjetjet e zgjidhjeve marrin

shumë kohë. Pra, në variantin e fundit kjo zgjidhje do të jetë për 5 vjet apo mund të jetë edhe e përhershme.

Prandaj, përkundër vërejtjeve dhe sugjerimeve tona, ne si Aleancë konsiderojmë se projektligji të cilin e kemi përpara për transmetuesin publik të Kosovës, marrë në përgjithësi, ka shënuar një performancë cilësore gjatë hartimit të tij, sidomos bie në sy krijimi i një infrastrukture ligjore më të avancuar, adresimi i çështjeve që kanë të bëjnë me objektivat, veprimtarinë dhe parimet themelore programore të transmetuesit publik, siç është sigurimi i transmetimit të programeve me standarde të larta profesionale në interes të publikut të gjerë në Kosovë.

Pra, edhe një herë po e përmend se sugjerimet e grupit do të jepen në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputeti Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke përshëndetur ardhjen e Projektligjit për transmetimit publik në Kosovë, koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar këtë projektligj, të cilin e përkrahim në parim. Ligji është i përgatitur mirë, por ka nevojë për disa sqarime, të cilat besojmë që gjatë shqyrtimit në komision do t'i qartësojmë.

Ftojme që gjatë shqyrtimit në komision të bëjmë sigurimin e një financimi stabil për RTK-në dhe gjithashtu vërejtjet tona do t'i adresojmë konkretisht në komisionin përkatës. Pra, Koalicioni për Kosovë të Re do të miratojë projektligjin në parim.

KRYESUESI: Faleminderit!

Koalicioni, “6 +”, deputeti Enis Krvan e ka fjalën.

ENIS KRVAN: Ju faleminderit nënkryetar!

Kamu Yayını Yasa Tasarısı ve RTK Yasa Tasarısı'nın ilk okunuşunu Parlamenter Grubu olarak kabul etmekteyiz. Acak kimi uyarı ve önerilerimizi paylaşırken önerge olarak da mevcut komisyona sunacağımızı belirtmek isterim. Yasanın 8. maddesinin 2. fıkrası Arnavutça ve Sırpça osmak üzere iki kanaldan yayın yapacağından söz etmektedir. Oysa bu diller dışında Türkçe ve diğer topluluk dillerine yönelik üçüncü bir kanalın daha bu yasayla garanti altına alınması gerekmektedir. Topluluklara yönelik yüzde on beşlik yayın sürelerinin de yetersiz olduğunu belirterek 8. maddenin 2.2 fıkrası radyo kanallarından söz etmektedir. Fakat topluluk dillerindeki radyo zaman zamanlamasını düzenlememektedir, bunun da bu yasayla düzenlenmesi gerekmektedir. 12. madde RTK'nın Kosova genelinde yayın yaptığını belirtmektedir. Oysa diğer taraftan yıllardır Jupa ve Gora bölgesinde özellikle Boşnakların yaşadığı topluluklar bölgelerde Yanova'da Türklerin yaşadığı yerlerde maalesef yıllardır bu kanal yayın yapmamaktadır.



Son olarak da özel ilgiye muhtaç çocuk programlarının ve özel ilgiye muhtaç bireylerimizin Türk dilinde de yayınların yapılanmasını düzenleyecek olan fıkraların da bu kanuna eklenmesi gerekmektedir. Ve tabi ki bizler de Parlamenter Grubu olarak TRK Bordunda topluluk sayısının artmasından yanayız ve bununla birlikte de cinsiyet eşitliğini gaz önünde bulundurarak bayan üye sayılarının ikiden dert veya beşe çıkarılmasından yana olduğumuzu belirtmek istiyorum.

Saygılar

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Është paraqitur deputetja Blerta Deliu - Kodra

BLERTA DELIU- KODRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Që në emërtimin e tij, Projektligji për transmetime publike në Kosovë, konsideroj se nuk është në rregull, për shkak se ky emërtim fillimisht lejon themelimin e shumë transmetuesve publik, ndërkaj, ne deri më tani asnjëherë nuk e kemi hapur temën për më shumë se një transmetues publik.

Nëse e shikojmë nën për nën projektligjin, flitet për transmetuesin publik që është Radiotelevizioni i Kosovës, ndërkaj projektligji duhet të emërtohet Projektligji për transmetime publike. Prandaj, konsideroj se ky ligj duhet të emërtohet - Projektligji për transmetuesin publik në Kosovë, madje ky është edhe rekomandim i Komisionit Evropian në Kosovë.

Neni 13, pika 5 e këtij projektligji, e ndalon dhënien e hapësirës reklamuese për producentët e pavarur që paguhen me mjetet e Radiotelevizionit të Kosovës. Duke u nisur nga gjendja aktuale financiare e RTK-së, konsideroj se nuk duhet ndaluar hapësira reklamuese, madje mendoj se RTK, duhet të mendojë që producentët e pavarur, mos t'i paguajë me mjetet e veta, por t'u jap vetëm hapësirën reklamuese për aq sa edhe ata e kanë vlerën. Kjo do të lehtësonte shumë buxhetin e Radiotelevizionit të Kosovës. Prandaj, mendoj se ky nën duhet të riformulohet në atë mënyrë që të bëhet më funksional.

Konsideroj se RTK duhet të ketë hapësirën e saj reklamuese, por të ketë edhe kontroll të shtuar pasi që shumë ka pasur edhe spekulime në këtë drejtim për keqpërdorim të mjeteve. Ndërkaj, në pikën 6 të këtij neni, thuhet se procedurat, kushtet dhe kriteret më të hollësishme për porositjen e veprave audio-vizuele, dhe të tjerat e përafërta nga producentët e pavarur, dhe për transmetimin e tyre në pajtim me këtë ligj, duhet të përcaktohen me rregullore të brendshme, të harmonizuar me legjislacionin vendor. Në këtë pikë konsideroj se do të duhej të shtohet edhe: ” praktikat e transmetuesve publik me vendet e Bashkimit Evropian”

Kurse, sa i përket kanalit në gjuhën serbe, konsideroj se ky medium duhet të quhet RTK 2 dhe selia e tij duhet të jetë në të njëjtin vend ku është edhe selia e kanalit në gjuhën shqipe, për shkak se kjo do të kishte edhe qasje integruese. Nuk guxojmë të lejojmë që

edhe më tej të enklavizohen institucionet e vendit, prandaj kërkesa për seli në Graçanicë e këtij mediumi është e pamundshme teknikisht, fillimisht dhe e dyta nuk i kontribuon integritetit dhe bashkëpunimit mes komuniteteve në Kosovë. Sigurisht që kanali televiziv në gjuhën serbe që do të quhej RTK 2, do të ketë strukturë organizative njëjtë sikurse edhe kanali në gjuhën shqipe RTK 1, ndërsa zgjedhja e drejtorit dhe e kryeredaktorit të këtij kanali, bëhet në procedurë të njëjtë sikurse edhe zgjedhja e drejtorit në kanalin në gjuhën shqipe.

Dhe në fund po e ripërsëris edhe kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së, që në nenin ku thuhet që RTK mund të hapë edhe kanale të tjera sipas nevojës, të përfshihet edhe iniciativa e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, që të futet edhe kanali për Parlament, i cili do të kontribuonte që punët nëpër komisione parlamentare, por edhe seanca dhe aktivitetet e tjera të këtij Kuvendi, të jenë pjesë e këtij kanali. Konsideroj se në këtë mënyrë, ne do të promovojmë transparencën parlamentare.

KRYESUESI: Deputetja Hadergjona e ka kërkuar fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

E pash të arsyeshme të ngrejë një çështje që ka të bëjë me Ligjin për transmetuesin publik. Ne e dimë shumë mirë kur kemi miratuar buxhetin e vitit 2011, në Komisionin për Buxhet dhe Financa është rekomanduar që Radiotelevizioni i Kosovës të paguhet nga buxheti i Kosovës vetëm gjatë vitit 2011 dhe ai të jetë si program i veçantë në kuadër të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në vitet tjera të gjendet mundësia e financimit të Radiotelevizionit të Kosovës. Ne gjatë punës në këtë projektligj, që unë nuk them që ta refuzojmë, mirëpo duhet menduar seriozisht të gjithë deputetët e Kuvendit, a duam që ky radiotelevizion të jetë një radiotelevizion shtetëror, apo një radiotelevizion publik? Nëse duam që të jetë publik, atëherë duhet të gjenden mënyra tjera të financimit dhe jo nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Unë për njohurinë e deputetëve këtu, dua të them se as në buxhetin e vitit 2012 dhe as në kornizën afatmesme 2012-2014, nuk janë të parapara mjete për Radiotelevizionin e Kosovës nga buxheti i Republikës së Kosovës. Prandaj, duhet menduar shumë mirë kur e miratojmë këtë ligj, sepse nëse shkohet siç është paraqitur në projektligj, thotë: "për një periudhë tranzitore deri në trevjeçare, deri në sigurimin e financimit nga parapagimi, çdo vit RTK-së, i ndahen 0.7% e të hyrave nga buxheti i Kosovës, duke përjashtuar të hyrat nga proceset e privatizimit, të hyrat e njëhershme për buxhetin e Kosovës dhe të hyrat vetjake të nivelit qendror dhe komunal"

Nëse mbetet ky nen kështu, siç është formuluar në Projektligjin për transmetuesin publik, atëherë duhet të mendojë shumë mirë, duhet të mendojë Qeveria se ku do t'i shkurtojë këto mjete buxhetore dhe t'i ndajë diku 8 deri 9 milionë euro për çdo vit edhe në Kornizën afatmesme 2012 – 2014, e cila ka qenë në diskutim në Kuvend dhe nuk janë të parapara këto mjete. Prandaj, unë tërheq vëmendjen se duhet menduar seriozisht me rastin e gjetjes së mënyrës apo të mbetet kështu siç është në projektligj apo të gjendet mënyra për financim tjetër e Radiotelevizionit të Kosovës?

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputetja Lama edhe njëherë, nuk e di a ka replikë, a ka..., diçka do të thotë.

ALMA LAMA: Po flas në emrin tim personal. Në lidhje me këto sugjerimet që thotë zonja Safete, është e vërtetë, mirëpo për shembull, në propozimin që bëra unë që disa programe të financohen nga buxheti, që ishin kryesisht ato programe të cilat nuk e prekin pavarësinë editoriale, është model i marrë nga BBC, të njëjtën gjë e bënë BBC dhe mendoj që është modeli më i mirë që mund të marrim parasysh.

Ndërsa, për sa i përket kanalit të Parlamentit, nga modelet që kemi shqyrtuar në vendet e ndryshme të botës, kostoja për këtë është shumë e vogël, për shembull Italia që ka dy dhoma, edhe Senatin edhe Parlamentin dhe që ka një kanal parlamentar, koston vjetore e ka 1.500.000 euro, sepse bashkëpunon me transmetuesin publik. Në këtë logjikë, do të mund të bëhej edhe kanali RTK Parlament ose RTK Kuvend dhe besoj kostoja do të ishte shumë më e vogël, duke pasur parasysh që përmasat e Kuvendit të Kosovës janë më të vogla. Për të tjerat, natyrisht që është shumë e rëndësishme që për transmetuesin publik të paguajnë qytetarët, të paguaj publiku sepse kjo është mënyra e vetme se si garantohet pavarësia editoriale.

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që televizioni publik të heqë dorë, ashtu sikurse kanë bërë televizionet e tjera, për shembull BBC, nga disa programe të cilat nuk janë realisht në misionin e tij. Për shembull, programet e shumta sportive nuk janë në misionin e televizionit publik, ashtu sikurse edhe programe argëtuese, seriale e tjerë. Misioni kryesor është informimi dhe besoj se këtu duhet t'i japim mbështetjen më të fortë dhe këtu do të jetë investimi më i madh në të gjitha kapacitetet e këtij radiotelevizionit publik.

KRYESUESI: Ju faleminderit! shpresoj që do të gjenden rrugët për t'u financuar. Deputetja Donika Kadaj - Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Po dua veç të shtoj, të jap një kontribut, ose ndoshta më tepër një opinion që ashtu sikurse edhe kolegja Safete, jam shumë e shqetësuar, do të thotë, me përpjekjen ose mënyrën e sjelljes në Kuvend të këtij projektligji, ku financimi i transmetuesit publik do të bëhet përmes Kuvendit.

Unë po ashtu jam ithtarë e asaj që Televizioni publik nuk guxon të financohet nga buxheti i shtetit, sepse drejtpërdrejt do të ketë ndikim në politikën e tij redaktuese. Cila është mënyra për ta gjetur, konsideroj që në Kosovë, por edhe jashtë ka ekspertë dhe prej përvojave, edhe ndërkombëtare, edhe në rajon ne duhet të gjejmë një formë tjetër dhe të mos zyrtarizojmë apo ta bëjmë me ligj në një formë apo tjetër kontrollin e politikës në RTK. Në momentin që RTK-ja financohet prej buxhetit të Kosovës, automatikisht do të jetë i varur dhe kjo nuk do të shkojë në shërbim të transparencës dhe në shërbim të përmirësimit të fjalës së lirë në vend.

Prandaj, edhe duke pasur parasysh problemet e shumta buxhetore të cilat u përmenden nga kryetarja e komisionit, unë konsideroj se aspekti i lirë së shprehjes në këtë rast, është i rëndësishë së veçantë dhe ne duhet të gjejmë forma të tjera dhe jo shteti të financojë televizionin publik, përndryshe do të kemi televizion shtetëror, televizion të cilin e kemi parë ne vende jodemokratike. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Edhe Qeveria nuk ka vërejtje. Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për transmetim publik. Në sallë janë prezentë 68 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitet për votim. Votojmë tani.

Me 64 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, konstatoj që Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për transmetimin publik në Kosovë.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në aftin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojmë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesim raportin me rekomandime.

A të propozojmë 15 minuta pauzë, për cigare.

Po, po, e vazhdojmë nëse nuk jeni lodhur. Ani, e vazhdojmë, pra.

Po kërkohet që të vazhdohet, e vazhdojmë.

Pika e katërt e rendit të ditës:

#### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik**

Të nderuar deputetë,

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 26 korrik 2011, ka propozuar që shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe të Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, të bëhet me procedurë të përshpejtuar. Andaj, para se të fillojmë me shqyrtim, kërkojmë deklarimin e deputetëve me votim për shmangien nga Rregullorja e Kuvendit, në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit. Për shmangie nga Rregullorja, kërkohet miratimi i 2/3 të votave të pranishëm në mbledhjen plenare.

Në mbledhje nuk kemi kuorum, andaj po marrim pauzë 15 minuta.

*Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi*

**KRYETARI:** Të nderuar deputetë,

Vazhdojë me Shqyrtimin e parë të Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Prezent kemi 61 deputetë.

Ne duhet të votojmë që ky ligj dhe ligji pas tij duhet të shkojmë me procedurë të përshpejtuar, kështu që na duhet një votim me 2/3 e deputetëve prezentë.

Kush është që këto dy ligje në leximin e parë të shkojnë me procedurë të përshpejtuar, do të thotë për pikën 4 dhe pikën 5 të rendit të ditës.

Ju faleminderit!

A ka kundër? 3 vota “kundër”. Konsideroj që shumica absolute ka votuar “për”.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

**MINSITRI BEDRI HAMZA:** I nderuari kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t’i paraqes Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ky projektligj është rezultat i punës dhe përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj. Ky projektligj përcakton rregullat e detyrueshme për zyrtarë të lartë publikë, që gjatë ushtrimit të funksionit publik të parandalojë konfliktin e interesit të tyre në mes të interesave publike dhe private, si dhe përcakton kufizimet bazë për zyrtarë të lartë publikë në ushtrimin e funksionit publik dhe të funksioneve tjera që nuk janë të natyrës publike.

Projektligji i ri përmban risi në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik, siç është deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarëve të lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim detyrohet të bëjë deklarimin paraprak rast për rast të ekzistencës të interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në çështjet e caktuara që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

Përveç kësaj, një tjetër risi është edhe zbritja e vlerës së kapitalit nga 20% në 5%, kur zyrtari i lartë publik është pronar i aksioneve të kapitalit të ndërmarrjes, i cili do të jetë i obliguar t’i transferojë të drejtat e administrimit ose menaxhimit në drejtimin e ndërmarrjes në ndonjë person të besuar. Me Projektligj po ashtu janë përcaktuar përgjegjësitë dhe kompetencat e Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik. Në këtë projektligj janë përcaktuar sanksionet kundërvajtësve, gjohet maksimale të lejuara, si dhe procedurat e shqiptimit të tyre. Në rast të përsëritjes së konfliktit të interesit, kërkohet nga institucioni në të cilin zyrtari ushtron veprimtarinë e tij, që ndaj tij të fillohet procedura e shkarkimit, ndërsa në rast kur shkelja ka dëmtoar interesin publik, atëherë Agjencia lajmëron organet e ndjekjes për ndërmarrjen e masave adekuata në pajtim me ligjet.

Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me ekspertë të brendshëm dhe ndërkombëtarë, në bashkëpunim me zyrat përgjegjëse të Agjencisë kundër Korrupsionit, si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, andaj i nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë, jemi të bindur se aprovimi i këtij projektligji është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë dhe avancimit të

standardeve më të larta sa i përket parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, si dhe eliminimit të një sfide që është paraparë në Raportin e progresit të Komsionit Evropian. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Fjala është për kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion, deputeti Arben Gashi, nëse e donë fjalën. Mirë, ju faleminderit! Atëherë, shkojmë në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Projektligjin e përkrahim në parim, ndërsa kontributin do ta japim në komisionin përkatës.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, do të paraqes disa vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj. Konkretisht, me nenin 8, theksohet se zyrtari i lartë ka për detyrë që të parandalojë dhe zgjedhë vetë brenda afatit ligjor çdo situatë të konfliktit të tij të interesit.

Sipas mendimit tonë, mirë është që të theksohet ligji në të cilin parashihet afati i tillë ligjor ose në këtë dispozitë të përcaktohet një afat konkret se a do të jetë ky afat 15 ditë apo 30 ditë, do të shihet në komision më tutje.

Më tutje, në nenin 12, pika 4, thuhet se nëse konstatohet se votimi dhe vendimi është në kundërshtim me vullnetin e zyrtarit të lartë, kuptohet për shkak të ndikimit të jashtëm ndaj tij, për shkak të dhuratës apo ndonjë premtimi tjetër, në dispozitë thuhet se ky vendim duhet të shpallet i pavlefshëm nga institucioni, por ne si Grup Parlamentar i LDK-së, mendojmë që përveç anulimit të vendimit të tillë, duhet të parashihet edhe ndonjë masë ndëshkimore apo ndonjë sanksion ndaj zyrtarit të lartë.

Më tutje, në nenin 18, pika 7, theksohet se nëse pas zgjedhjes, emërimit ose konfirmimit të mandatit, zyrtari i lartë vazhdon të kryej një aktivitet apo funksion që ky ligj e përcakton si të papajtueshëm me funksionin e ri, më tutje vazhdon, agjencia paralajmëron zyrtarin e lartë dhe vendos një afat, sipas të cilit atij do t'i kërkohet të ndërpresë aktivitetin apo të heqë dorë prej postit. Mirë është që edhe në këtë nen, konkretisht në këtë paragraf, të theksohet afati i tillë.

Kurse në nenin 18, pika 10, theksohen rastet kur deputeti i Kuvendit ushtron aktivitetet të papajtueshëm me këtë ligj. Agjencia e njofton kryetarin e Kuvendit dhe kërkon fillimin e procedurës ndaj tij. Ne si Grup Parlamentar i LDK-së mendojmë se nuk ka nevojë që në këtë nen, por as në këtë ligj në përgjithësi, të specifikohet vetëm posti i deputetit, sepse me nenin 4 të këtij ligji, parashihen me dhjetëra, për të mos thënë me qindra zyrtarë të lartë, duke filluar nga Presidenti i vendit e deri te kryeinspektori i nivelit qendror dhe ai i nivelit lokal. Andaj, mirë është që mos të specifikohet vetëm posti i deputetit të Kuvendit. Ndërsa, në nenin 18, paragrafi 11, haset formulimi: “Agjencia brenda afatit të përcaktuar”. E mirë është që në vend të fjalës “pacaktuar”, të jetë teksti me të cilin përcaktohet afati i saktë i veprimit.

Dhe, krejtësisht në fund, i tërë neni 18 rregullon procedurat administrative të Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit. Mirëpo, nuk rregullohen çështjet e vendimit të Agjencisë, si dhe e drejta e ankesës së zyrtarit të lartë, nëse vlerëson se me një vendim të tillë i është bërë e padrejtë. Andaj, shtrohet pyetja: A ka të drejtë zyrtari lartë të bëjë ankesë ndaj vendimit të tillë. Pastaj, a ka ndonjë afat të caktuar për ushtrim të një ankese të tillë, si dhe kush është apo cili është organi që vendos lidhur me ankesën e tillë sepse, po theksoj, në këtë draftligj vetëm theksohet se vendimet e Agjencisë publikohen në Web faqe.

Në fund, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, theksoj se në parim e përkrahim procedimin e mëtutjeshëm të këtij ligji, në mënyrë që në procedurat e mëtutjeshme të aprovohet.

**KRYETARI:** Ju faleminderit!

Në emër të Grupit “Vendvendosje”, deputetja Alma Lama e ka fjalën.

**ALMA LAMA:** Ju faleminderit, zoti kryetar!

Ne vlerësojmë se ky ligj është mjaft i rëndësishëm, mirëpo nuk pajtohemi me mënyrën se si po kalon proceduralisht, sepse po bëhet si praktikë që të kalojë me procedurë të përsheptuar. Është fat që ky ligj është i mirë, por në rast se kjo metodë përdoret edhe për ligjet e tjera, dihet që do prodhojmë ligje jo shumë të mira dhe do të duhet t'i kthejmë sërish në Kuvend, siç po ndodhë faktikisht që po rikthehen ligjet të njëjta çdo vit.

Në lidhje me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe të ushtrimit të funksionit publik, mund të themi se është një ligj i punuar mirë dhe janë marrë parasysh vërejtjet e Agjencionit Antikorrupsion, sepse ky është një nga ligjet bazikë me të cilin funksionon ky agjencion i pavarur. Mirëpo, unë do të propozoja që të futet një nen i veçantë, ku thuhet se zyrtarët e lartë nuk mund të jenë anëtarë të bordeve të kompanive publike, përveç se në rastet kur ato përfaqësojnë aksionet e Qeverisë në këto borde.

Kjo është shumë e rëndësishme, sepse shpesh po ndodhë që zyrtarë të lartë të influencojnë në këto borde për interesa personale. Për sa i përket nenit 14, propozoj që të dy pikat të rishkruhen këtë mënyrë: “Personi zyrtar i lartë, pronarë i aksioneve në vlerën mbi 5% të kapitalit të ndërmarrjes, gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të

transferojë të drejtat e administrimit ose menaxhimit të drejtimit të ndërmarrjes tek te një person i besueshëm”.

Ndërsa, pika 2: “Personi zyrtar i lartë është i detyruar që brenda afatit prej 30 ditësh, që nga momenti i zgjedhjes, vendosjes ose emërimit në postin zyrtar, të bëjë transferimin e të drejtave të udhëheqjes së ndërmarrjes tek personi i besueshëm dhe brenda afatit prej 5 ditësh, nga data e transferimit të këtyre të drejtave, duhet ta njoftojë me shkrim Agjencinë”. Propozojmë që të rishkruhet sepse në ligj është shumë, shumë e paqartë.

Ka edhe pika të tjera të cilat mund të rishkruhen pa ia humbur kuptimin, por vërejtjet do t’i kalojnë komisionit, ndërsa në parim edhe ne e mbështesim këtë ligj. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Ju faleminderit!

Procedurat e përshpejtuara po bëhen për leximin, në parim. Nuk janë duke u bërë për fazën e dytë, kur ligji përmbajtësisht duhet të ndryshohet. Pastaj, është neni i caktuar i Rregullores së Punës së Kuvendit që parasheh mundësinë edhe të procedurave të përshpejtuara. Gjithçka jemi në kuadër të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Donika Kadaj - Bujupi e ka fjalën.

**DONIKA KADAJ - BUJUPI:** Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

Perceptimi publik është se në Kosovë konflikti i interesit është mjaft i përhapur, nëse ky fenomen korruptiv nuk parandalohet dhe as luftohet efektivisht dhe në mënyrë sistematike. Sot edhe mungesa e Qeverisë derisa pavarësisht që e lexojmë në parim këtë projektligj, e diskutojmë, tregon për faktin se ne kemi një problem në përgjithësi si shoqëri, a ka mungesë të vullnetit politik që të parandalojmë do të thotë konfliktin e interesit, që rrjedhimisht lidhet me korrupsion, apo po i bëjmë ligjet vetëm sa për t’i pasur dhe për t’i përmbushur objektivat, qoftë të Kuvendit, qoftë të Qeverisë, por zbatimi i tyre të jetë larg.

Kjo është edhe për shkakun se adresimi efektiv i konfliktit të interesit, varet nga korniza gjithëpërfshirëse e politikave kundër korrupsionit dhe prandaj edhe ky projektligj duhet parë si i ndërlidhur ngushtë me to, e jo si një tërësi çështjesh të izoluara nga kjo kornizë, për shembull, si në aspektin e kornizës rregullative, ashtu edhe në atë të zhvillimit, të implementimit të politikave dhe të strukturave institucionale për zbatimin e efektshëm të tyre.

Pasi që jemi në fazën fillestare të kompletimit të kornizës ligjore, sepse do të thotë edhe sot veç se e kemi ligjin e radhës, i cili do të lidhet me kompletim të kësaj kornize, për parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni korruptiv në kuadër të kornizës së politikave kundër korrupsionit, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozon që projektligji duhet të adresojë edhe aspektet e integritetit, transparencës, llogaridhënies e qeverisjes së mirë, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin institucional dhe transformime afatgjata të mentalitetit. Këto propozojmë që ndër të tjera, do të thotë në kornizën e politikave kundër korrupsionit të kemi edhe një normë juridike që lidhet me komitetet e



etikës pranë institucioneve qendrore dhe lokale, të cilët do të jenë mekanizma shtesë për zbatimin dhe fuqizimin e ligjit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Duke marr parasysh se një projektligj të tillë, me sa më duket e kemi pasur edhe përpara, por sipas të gjitha gjasave ka pasur problem në zbatueshmërinë e tij më të qartë dhe jep për të treguar që rrethanat në çfarë ndodhet shteti i ri i Kosovës, duhet të ketë infrastrukturë më të mirë ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, që nuk është e lehtë të zbatohet. Mirëpo, prapë se prapë ky projektligj, përfaqësuesi nga LDK-ja i dha disa vërejtje, të cilat edhe unë kam pasur ti jap, mirëpo ai i tha përpara. Në parim, mund të përkrahet dhe të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet do t'i japim në Komisionin Parlamentar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të SLS-së, nuk ka të lajmëruar. Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, fjalën e ka deputetja Myfera Shinik.

MÜFERA ŞİNİK Teşekkür ederim sayın başkan

Kamu görevlilerinin çıkar çatışmasının önlenmesi Yasa Tasarısı, 6+ Parlamenter Grubu tarafından kabul edilmektedir, önerilerimizi komisyonlara sunacağız.

Zoti kryetar, shfrytëzoj rastin për një vërejtje teknike në materialin të cilin e kemi në rend dite. Pika 12, thotë: “Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së, për emërimin e anëtarit të Komisionit për të Drejtat, Interesat e komunisteve dhe për kthim” në vend të fjalës: “komunisteve”, duhet të jetë për “komuniteteve”. Kjo është turp për neve. Të lutem, një kujdes që të mos përsëritet ky gabim. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Edhe unë po kërkoj që administrata të jetë e kujdesshme në shkrime. Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

U tha këtu që mendohet se kemi pasur një ligj, jo një por dy variante të këtij ligji i ka aprovuar ky Kuvend, natyrisht në legjislatura të tjera. Unë nuk shoh ndonjë ndryshim specifik me ato dy të tjera. Me kujdes e kam lexuar ligjin, sepse është një ligj që pretendon të bëjë atë që quhet në gjuhën e përditshme, gati në mënyrë të modës, transparencë. Mirëpo, neni 4, ku klasifikohet kush është zyrtar i lartë publik, duhet të rishikohet sepse mua më duket që është ngarkesë totale dhe do të ishte çudi e zotit nëse janë zyrtarë të lartë publikë krejt këta që janë të numëruar këtu. Është neni 4, ky duhet të shikohet kur të amendamentohet, sepse ne kemi pasur edhe ligje të tjera, më duket një

para këtij, ku zyrtarë të lartë politikë janë tri kategori, krejt, këtu dalin shifra që unë nuk mund t'i them sot. Pra, përkufizimi themelor, neni 4 duhet të shikohet.

Po, unë tash po ndalem prej tjerave, duhet të ndalem te neni 22, që është shumë specifik. Kurrë nuk e kam dëgjuar në legjislacion këtë, i cili thotë: “Autoriteti qendror përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji mbikëqyrës, përgjegjës është Agjencia”. Unë po e them, nënkuptohet (Agjencia kundër Korrupsionit. Nuk ka ligj që e kemi aprovuar ne, që specifikohet një agjenci të jetë përkujdesja kryesore e zbatimit të ligjit. Ky është nën joprofesional, mendoj. Duhet të mendohet që Agjencia është e implikuar shumë në këtë ligj dhe në atë tjetrin, që vjen pas këtij dhe bile mund të them që është stërmadhim i funksionit përkujdesues të një agjencie, qysh është Agjencia kundër Korrupsionit në dy ligje që pretendojnë të jenë ligje të forta sistimore.

Pse e them këtë? Sepse duhet të rridefinohet Ligji për Agjencinë, kompetencat, integriteti, fuqia përcjellëse e asaj agjencie, që me gjendjen e tashme që e kemi, nuk mund ta bëjë këtë punë, as ta zbatojë nenin 22. Po rezymo. Mendoj që neni 22 duhet të fshihet krejt, sepse është Kuvendi për kah natyra e tij e punës që monitoron zbatimin e ligjeve në të gjitha nivelet, mandej vijnë ministrinë e veçanta ose agjencitë e veçanta.

Edhe një herë po them, meqë zmadhohet deri gati në pakuptim funksioni i një agjencie, që ne e dimë cila është, edhe kapaciteti edhe fuqia e integritetit, të gjitha, është mirë që ky raport të shihet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Mendoj që komisioni gjatë punimit të ligjit do ta ketë parasysh këtë vërejtje me interes. Nuk kemi të lajmëruar të tjerë për diskutim. Shkojmë procedurën e votimit. Votojmë, tash. Prezent kemi 65 deputetë.

Me 61 “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit, të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën e radhës:

##### **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë**

Ftoj Ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'i paraqes Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Ky Projektligj është rezultat i punës dhe përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë.

N fillim, dua të theksoj se dispozitat e këtij projektligji janë në harmoni të plotë me dispozitat e legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe shteteve më të zhvilluara, gjë për të cilën flet edhe Deklarata e pajtueshmërisë me Legjislacionin e BE-së, të lëshuar nga Ministria e Integrimeve Evropiane. Ky projektligj ka për qëllim të përcaktojë detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë për ta deklaruar pasurinë, të hyrat, prejardhjen, detyrën e Agjencisë për ta kontrolluar deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, si dhe detyrimet e të gjithë personave zyrtar për t'i deklaruar dhuratat dhe prejardhjen e tyre. Ky projektligj po ashtu rregullon procedurën e deklarimit dhe kontrollin e pasurisë, të hyrat, detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë, anëtarëve të familjes dhe sanksionimin e tyre. Gjithashtu, ky projektligj rregullon procedurën e deklarimit, kontrollit për dhuratat dhe prejardhjen e tyre të pranuar nga të gjithë personat zyrtarë.

Me këtë projektligj përcaktohen në mënyrë të qartë kufizimi i zyrtarëve të lartë publikë, rritja e numrit të zyrtarëve të lartë publik që kanë për detyrë deklarimin e pasurisë, përcaktimi i detyrave të zyrtarit kontaktues, zyrtar i cili koordinon punën në mes të institucionit ku është i punësuar dhe Agjencisë, si dhe përcaktimin e politikave më të ashpra ndëshkimore.

Projektligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, me qëllim të krijimit të mekanizmave ligjor për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

I nderuari, zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Jemi të bindur që aprovimi i këtij projektligji është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë dhe të avancimit të standardeve më të larta sa i përket parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, si dhe eliminimi i një sfide që është paraparë në raportin e progresit të Komisionit Evropian. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Ju faleminderit, ministër!

Po shkojmë drejtpërsëdrejti te grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

**ARSIM BAJRAMI:** Ju faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i jep përkrahje parimore këtij projektligji, duke e vlerësuar si një projektligj shumë të rëndësishëm në mesin e pakos së ligjeve që sigurojnë transparencën e punës së zyrtarëve të lartë publikë dhe ky ligj, në fakt, ka dy

qëllime kryesore. E para, që të regjistrojë prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe të bëjë regjistrimin e dhuratave që marrin zyrtarët publikë. Ligji është plotësisht me standarde të larta evropiane, sepse parasheh transparencë në përcjelljen e pasurisë të zyrtarëve publikë, duke parashikuar tri faza të përcjelljes së pasurisë. Faza e parë, në momentin kur një zyrtar publik emërohet apo merr detyrën, raportimi i rregullt vjetor dhe raportimi pas përfundimit të mandatit.

Është shumë e rëndësishme edhe pjesa e ligjit që flet për regjistrimin e dhuratave të zyrtarëve publikë, në mënyrë të veçantë rregullohet statusi i dhuratave protokollare, do të thotë statusi juridik i dhuratave protokollare, duke vendosur një rregull, një kufizim, një rend dhe mendojmë se ky projektligj krijon një bazë të mirë që vërtetë të sigurohet transparenca e punës të zyrtarëve publikë dhe është edhe pjesë e pakos së ligjeve kundër korrupsionit. Edhe një herë, Grupi Parlamentar i jep përkrahje parimore dhe do të japë kontributin në leximin e dytë.

**KRYETARI:** Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

**ARMEND ZEMAJ:** Ju faleminderit, kryetar!

Kolegë të nderuar deputetë,

Së pari, më duhet të them se Grupi Parlamentar i LDK-së i jep përkrahje çdo projektligji i cili e ka për qëllim ta luftojë korrupsionin apo t'i forcojë masat për parandalimin e korrupsionit në mënyrë sa më efikase. Por, më lejoni të them se ky projektligj, siç duket, më shumë ka ardhur si vërejtje e Raportit të progresit, se sa një projektligj i ri, për dallim nga ligji paraprak, i cili ka pasur të bëjë me deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Prandaj, janë dy çështje që janë shumë thelbësore. Cili është efektiviteti i kontrollit të dhënave të deklaruara dhe kontrolli i burimit të krijimit të asaj pasurie. Edhe vetë përfshirja se kush është zyrtar publik dhe ndarja në pjesën tjetër, dhurata për të gjithë personat zyrtarë, tregon se kemi të bëjmë me një ligj voluminoz, i cili përfshin autoritete apo persona të cilët Agjencia Antikorrupsion apo Kundërkorrupsion nuk ka kapacitete për t'i përcjellë këto çështje.

Neni 3, në pikën 1.1.5. janë përfshirë të gjithë auditorët e brendshëm të organizatave apo institucioneve buxhetore, në të cilat... dhe paramendoni cili është numri nëpër këto të gjitha organizata, 2 dhe 3 persona...

E dyta, neni 1.1.8. Këshilltarët e asambleve komunale. 35 komuna me një mesatare rritet numri për 1000 e diçka persona, që jo vetëm nuk do të ketë Agjencia kapacitete mbikëqyrëse, por edhe devalvon vetë ligjin dhe luftën kundër korrupsionit, sidomos për çështje që kanë të bëjnë me zyrtarët e lartë publikë.

Këto vërejtje janë shumë parimore nga Lidhja Demokratike e Kosovës për të ruajtur edhe esencën edhe kredibilitetin e vetë ligjit dhe për atë qëllimin për çka është formuar Agjencia Antikorrupsion.

Çështjet tjera që kanë të bëjnë me deklarin, sidomos me deklarin publik, edhe aty duhet të kemi një kujdes të veçantë. Ne kemi dy vite përvojë në deklarin publik të zyrtarëve apo të pasurisë së zyrtarëve të lartë dhe nuk kemi një efikasitet të shtuar rreth kontrollit të krijimit të hyrave apo burimet e financimit të atyre të hyrave. Prandaj, kjo duhet të shikohet me shumë kujdes nga komisioni dhe të gjithë deputetët.

Edhe ky ligj, edhe ligji paraprak janë në kolizion njëri me tjetrin, sidomos te çështja që kemi të bëjmë me zyrtarët e lartë publikë dhe ligjet tjera dhe mendoj që komisioni do të ketë shumë punë, sidomos në bashkëpunim edhe me Ministrinë sponzorizuese, që t'i eliminojë këto defekte.

Ne, edhe një herë i japim përkrahje në parim dhe kontributin tonë do ta japim maksimalisht në komisionin funksional. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputetja Albulena Haxhiu e ka fjalën!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Ligji për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë do të duhej të ishte njëri prej ligjeve bazike për sa i përket kodifikimit ligjor të luftës kundër korrupsionit.

Deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë është një mjet për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, mirëpo mënyra se si ky projektligj ka kaluar nëpër procedura dhe ka arritur deri këtu, tregon mungesën e seriozitetit ndaj luftës kundër korrupsionit.

Nëse si institucione jemi të interesuar që ta parandalojmë korrupsionin, atëherë do të duhej ndërruar qasjen ndaj mënyrës se si i procedojmë këto dokumente të rëndësishme.

Sidoqoftë, ne si Grup Parlamentar kemi bërë disa vërejtje në lidhje me këtë projektligj, i cili ka nevojë që edhe më tej të plotësohet dhe të qartësohet.

Tek neni 3, ku flitet për përkufizimet, te përkufizimi zyrtar i lartë publik, duhet të përfshihen zyrtarët, shefat, drejtorët e prokurimit nga niveli qendror deri te ai lokal, si dhe zyrtarët e komisioneve vlerësuese, pasi që këto pozita janë të ndjeshme dhe ndikojnë në shfaqjen e korrupsionit.

Në përkufizimin e anëtarit të familjes, duhet të shtohet, përveç bashkëshortes dhe fëmijëve, edhe këto kategori: babai, nëna, motra dhe vëllai.

Kreu V, që ka të bëjë me dispozitat ndëshkimore, pra neni 14 i këtij projektligji, na tregon se sa zemërgjerë janë treguar me zyrtarët e lartë hartuesit e këtij projektligji. Masat e parapara në këtë projektligj nuk janë ndëshkime, por stimulim i korrupsionit.

Pra, as në këtë projektligj nuk është përfshirë mundësia e shkarkimit të zyrtarit të lartë publik nga ana e institucionit, ku ai punon, nëse zyrtari refuzon deklarin e pasurisë edhe pas kalimit të afateve të caktuara.

Në bazë të këtij projektligji, Agjencia e njofton institucionin përgjegjës ku zyrtari punon për fillimin e procedurave për shkarkim, por nuk e definon se cila është ajo procedurë.

Andaj, ne konsiderojmë që pika 5 e këtij neni duhet të ndryshojë, si vijon: “Agjencioni Kundër Korrupsionit, brenda 30 ditëve i dërgon organit përgjegjës njoftimin e motivuar për largimin nga puna të zyrtarit që refuzon të deklarojë pasurinë. Organi përgjegjës brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit është i detyruar të marrë masa për largimin nga puna e zyrtarit që ka refuzuar deklarin”.

Ky projektligj nuk parasheh dispozita ndëshkuese as ndaj deklarin të rrejshëm të pasurisë, për çka ne propozojmë të njëjtën masë ndëshkuese, pra atë të largimit nga puna, e cekur më parë.

Në këtë projektligj duhet rregulluar edhe kur deklarimi refuzohet nga personat e zgjedhur ose nga ata me imunitet, por që edhe shumat e parapara si ndëshkime të jenë së paku dyfishi i atyre që janë të paraqitura në këtë projektligj.

Këto janë vetëm disa nga vërejtjet dhe propozimet që ne i kemi arritur t’i identifikojmë dhe analizojmë gjatë kohës që e kemi pasur në dispozicion. Pra, këto dhe të tjera shtesë do t’i adresojmë në komisionet përkatëse.

Krejt në fund, ne do të votojmë në favor të këtij projektligji, në mënyrë që t’i hapim rrugë në komisionin funksional. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-ës deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

**DONIKA KADAJ-BUJUPI:** Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

U thanë pak a shumë edhe vërejtjet të cilat Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i ka gjetur në këtë projektligj. Mirëpo, unë më duhet të them që përderisa lufta kundër korrupsionit nuk trajtohet si një platformë gjithëkombëtare, ku do të japim kontributin tonë të gjithë bashkë dhe do të kemi vullnet të madh politik për ta luftuar, ne do të kemi ligje të cilat do të vijnë këtu qoftë për t’u harmonizuar me kërkesat e raportit të progresit, por nuk do të kemi rezultate, ashtu siç nuk ka pasur ose kanë qenë shumë të pakta edhe në të kaluarën. Projektligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë, sa i përket qëllimit të tij përcakton detyrimet e zyrtarëve publikë për ta deklaruar pasurinë, dhuratat dhe prejardhjen e tyre.

Sa i përket fushëveprimit, ky ligj synon të rregullojë kontrollin publik të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, të hyrave, përfitimeve të tjera materiale dhe detyrimeve financiare të tyre, të anëtarëve të familjes së tyre dhe të personave të lidhur me ta dhe

gjithashtu përcakton sanksionet përkatëse. Domethënë, nga ana formale përmbush rregullimin e kësaj fushe. Mirëpo, përtej anës formale dhe strikte ligjore të deklarimit dhe publikimit të pasurisë, si akt simbolik i llogaridhënies dhe transparencës së të zgjedhurve dhe zyrtarëve publikë ndaj zgjedhësve dhe taksapaguesve, Projektligji ka domosdoshmëri dhe gjithashtu kërkon monitorim dhe kontroll sistematik të të dhënave mbi pasuritë e të zgjedhurve dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë nga ana e publikut. Përmes kësaj, synohet parandalimi i vazhdueshëm dhe sistematik i korrupsionit gjë që, nga ana tjetër, kërkon një fokus të veçantë në aspektet cilësore të deklarimit të pasurisë. Cilësia dhe standardet adekuate për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë kanë rëndësi kyçe, në mënyrë që ky mekanizëm i zbatimit të ligjit dhe të politikave kundër korrupsionit t'i shërbejë efektivisht qëllimit, do të thotë, që është parandalimi i korrupsionit. Këtu Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, do të thotë si Grup Parlamentar, kemi disa vërejtje tek mekanizmat kontrollues.

Sa i përket kontrollit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, ky ligj nuk përmban ndonjë dispozitë që përcakton procedurat dhe mekanizmat kontrollues. Përveç nenit 15, i cili përcakton detyrimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit për verifikimin e saktësisë së të dhënave të deklaruara në formular, domethënë merret me arkivim dhe administrim të dhënave, por nuk ka të specifikuar ndonjë mekanizëm për kontroll, prandaj konsiderojmë që grupet punuese, komisionet përkatëse duhet të fokusohen, në mes të tjerave, edhe në nenin 15. Konsiderojmë që duhet të shkojmë një hap më tutje që të themelojë mekanizma të verifikimit të prejardhjes së pasurisë, të verifikimit të përputhshmërisë së pasurisë së deklaruar dhe asaj reale.

E dimë nga ajo se çka po shohim në Kosovë, që në dekadën e fundit Kosova shpeshherë është konsideruar si një vend i mundësive, sepse do të thotë pasuria e njerëzve dy vjet më parë, tri vjet më parë, pesë vjet më parë ose prej vitit 2000 ka ndryshuar dhe sot është në shumta marramendëse, qoftë në emra të zyrtarëve të lartë ose të anëtarëve të familjes, të cilët edhe nëse nuk specifikohen si anëtarë të ngushtë, qëllonjë që të jenë vëllezërit ose motrat e zyrtarëve të lartë, do të thotë, atyre në emër të cilëve apo përgjegjësi e të cilëve janë transaksionet shumë të mëdha të parave të qytetarëve të Kosovës.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në parim e mbështet, e përkrah, mirëpo do të kërkojmë që zbatimi i tij të mos mbetet vetëm një fontanë dëshirash, por me të vërtetë të monitorohet për së afërmi nga Kuvendi dhe të kemi rezultate të kërkuara e të nevojshme. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën!

**MYZEJENE SELMANI:** Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se edhe pak më parë e patëm një projektligj të tillë, i cili është në një pako me këto ligjet të cilat mund të jenë ligje për zyrtarët që të bëjnë punën e tyre në mënyrë më transparente për arsye se janë direkt të kyçur në çështjet publike apo më shumë merren edhe me paranë publike, mund të themi se Projektligji në parim mund të përkrahet, mirëpo esenca e projektligjit është që ky ligj të zbatohet në mënyrë të qartë,

me sugjerimet të cilat u morën nga shumë deputetë këtu, që të jetë transparenca shumë e lartë e zyrtarëve të lartë për prejardhjen e pasurisë së tyre dhe dhuratave të tyre dhe njëkohësisht gjatë zbatimit të këtij ligji të bëhet në mënyrë shumë të qartë, prapë se prapë çështja që zyrtarët e lartë të mos korruptohen dhe ligji të zbatohet pikë e për pikë.

Të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet për këtë projektligj, Koalicioni për Kosovë të Re do t'i drejtojë në Komisionin për Legjislacion. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS nuk ka! Në emër të Grupit “6+”, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuari ministër,

Kolegë të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë projektligj për deklarime dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë dhe mendojmë se ky projektligj është i një rëndësie të veçantë duke pasur parasysh vetë faktin se në rend të parë ka për qëllim luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, si veti negative, dhe të keqpërdorimit të pozitës së zyrtarëve të lartë dhe ne si Grup Parlamentar e mirëpresim dhe e përkrahim këtë projektligj dhe, si të tillë, e përkrahim në parim. Ndërsa, kontributin tonë do ta japim përmes komisionit, në mënyrë që ky projekt të marrë formën e duhur dhe duke shpresuar në zbatimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I kemi edhe dy diskutues, Nijazi Idrizi, pastaj Sabri Hamiti e ka fjalën!

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryetar!

Unë e kam një vërejtje lidhur me nenin 13 pika 1, te regjistri i deklarimeve, në të cilin thuhet se deklaruesi është i obliguar që pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme t'ia caktojë vlerën e saj. Më duket se kjo është një shprehje e fjalorit të ekonomisë së planifikuar dhe si të tillë nuk duhet të ketë vend këtu për shkak se askush nuk mund ta caktojë vlerën e pasurisë së paluajtshme apo edhe të luajtshme, nëse ajo pasuri nuk nxirret në treg. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Po të analizohet mirë, edhe ky ligj ka tepër punë për t'u precizuar. Unë pajtohem që në kuptimin afirmativ duhet të themi që po mbarojmë ligje të përsosura evropiane, po nuk është gjithmonë kështu.

Shpresoj që në leximin e sigurt, edhe në kuptimin legjislativ edhe të materies, në leximin e dytë do të precizohen disa probleme.

Problemi i parë është në nenin numër 1, që thotë edhe një herë kush janë zyrtarë të lartë politikë, që është pak a shumë përshtetshëm, me një ndryshim të vogël te Kuvendi, ku thotë se edhe ata që i emëron Kryesia dhe kryetari i Parlamentit, janë zyrtarë të lartë, çfarëdo



qofshin ata. Regjistri është si ai i ligjit paraprak, kush janë zyrtarë të lartë, që unë s'po bindem fort që janë zyrtarë të lartë publikë i gjithë ai regjistër që do të bëhet, po kjo le të studiohet.

Ajo që është esenciale këtu, është neni 13, i cili në 5 paragrafët e vet ka shumë të panjohura që duhet të specifikohen.

Nëse në paragrafin e parë emërtohet çka do të deklarohet dhe në vazhdim të frazës së gjatë thuhet: "të gjitha këto duhet të publikohen në faqen e internetit të Agjencisë brenda afatit prej 60 ditësh", që është pak a shumë diçka që ka ndodhur dy-tri vitet e fundit te ne.

Paragrafi i dytë thotë: "qasja në të dhënat që nuk bëhen publike, e që kanë të bëjnë me deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, bëhet në përputhje me Ligjin për qasje në dokumentet publike", e tjera. Domethënë, ka specifikim që deklarohet dhe s'deklarohet.

Dhe tutje, pse ndodhë kjo? Ndodhë kjo sepse thotë: "përpunimi i të dhënave personale që gjenden në regjistër bëhet në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale".

Pra, kemi në fuqi ligje ne në Kosovë, që disa elemente që thuhet se duhet të bëhen transparente, nuk lejohen me ligje në fuqi. Prandaj, kërkoj që i tërë neni 13 të studiohet mirë në lidhmëni me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.

Dhe, po e shpjegoj prapë me një deklaram që ndodhi këtu. Thuhet, çdo ligj e ka njëfarë deklarate që në pajtim me *acquis* komunitarire, me ligje të Evropës..., kjo është pak më shumë dëshirore, se unë po ju them dhe ju, zoti kryetar i Parlamentit, jeni dëshmitarë, në *acquis* communautaire është Belgjika, Brukseli e qendra e saj. Në Belgjikë ndalohet një mori e të dhënave që të publikohen. Është e ndaluar me ligj, që këtu kërkohet në emër të transparencës. Janë një kategori përfaqësuesish shtetërorë që e kanë të ndaluar me ligj të tregojnë çka marrin, ku marrin, edhe gjendjen e tyre. Ju e dini pse është, njerëzit që e njohin në rezon, në detaj, e dinë pse ndodh ajo. Kështu që unë nuk po specifikoj më tutje, por po them, neni 13 bile të akordohet me ligjet në fuqi të Kosovës.

Dhe, ka edhe finesa tjera që janë në pa saktësi. Unë pak edhe sa për argëtim po ju them që, te neni 11, ku flitet për dhuratat, një herë thuhet që: "nuk merret dhuratë më shumë se 50 euro", mandej thotë: "nuk mund të merren dhurata, shuma vjetore e të cilave është më shumë se 100 euro", dhe menjëherë më tutje thuhet: "dhurata e rastit nuk mund të jetë më e madhe se 500 euro". Domethënë, le të shikohen këto probleme.

Për t'u bërë pak edhe më argëtuese, thotë: "përfaqësuesi nuk guxon të marrë dhuratë për pa e marrë lejen prej Agjencisë". Po merre me mend, një përfaqësues i lartë i Kosovës shkon në Bruksel e ia jep një dhuratë homologu i vet, duhet ta thërrasë Agjencinë në Prishtinë e ta pyet - a e marr, a po e shkeli ligjin? Kjo nuk ka kuptim, kjo duhet të sanksionohet ndryshe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në sallë kemi 65 deputetë!

Votojmë për ligjin, votojmë tash:  
Janë 67 deputetë prezentë!

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë peronat zyrtarë.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime. Faleminderit!

Xhavit, e vazhdon me pikën e radhës:

## **6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmën shtetërore**

KRYESUESI: Atëherë, besoj se jeni dakord me procedurat që i kemi filluar në mëngjes, me të shpejtë t’i votojmë.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndihmën shtetërore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Besoj se Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka diçka të veçantë. Vazhdojmë me miratimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.  
Nuk ka vërejtje. Miratohet.

Amendamenti 2.  
Nuk ka vërejtje. Miratohet.

Amendamenti 3.  
Nuk ka vërejtje. Miratohet.

Amendamenti 4.  
Nuk ka vërejtje. Miratohet.

Amendamenti 5.  
Nuk ka vërejtje. Miratohet.

I bini ziles edhe një herë, se s’paska tamam deputetë!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Zoti nënkryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, i thirrni deputetët...!  
Faleminderit!

Amendamenti 4.  
Nuk ka vërejtje, miratohet.

Amendamenti 5.  
S'ka vërejtje, miratohet.

Amendamenti 6.  
S'ka vërejtje, miratohet.

Amendamenti 7.  
S'ka vërejtje, miratohet.

Amendamenti 8.  
S'ka vërejtje, miratohet.

Amendamenti 9.  
S'ka vërejtje miratohet.

Tani, të nderuar deputetë, votojmë tekstin në përgjithësi. Elmi, të lutem, voto një herë, për një sekondë. Nuk mundemi, sepse nëse nuk je në sallë, ndërpritet seanca.

(Ndërhyrje)

Jo more, këtu duhet të rrini, qysh jashtë!? Voto! Nuk ka kuorum, 61 deputetë jemi, veç një deputetë në qoftë se nuk është, nuk mund të votojmë. Më fal!

Atëherë, votojmë Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. 61 deputetë janë në sallë, votojmë tani:

Faleminderit! Me 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim”, miratohet Projektligji. Pra, konstatoj se Kuvendi miratoi Ligjin për ndihmën shtetërore.

Atëherë, po i presim këta që të vijnë.

(Ndërhyrje)

Nuk ka komisione, shkoni turrni, kush ka shkuar në komisione, çfarë komisionesh sot. Nuk ka ditën e seancës komisione. Thirrni ose duhet t'ua heqim mëditjet atyre që janë në komisione. Çfarë komisione sot në seancë. Salla pa deputetë, e ata shkojnë... Për mëditje apo për çka janë shkuar atje?

(Ndërhyrje)

(Ndërprerje e incizimit)

Atëherë, janë 62 deputetë. Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

## **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të propozojmë me votimin e amendamenteve, ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Legjislacion, deputetin Arben Gashi, në qoftë se dëshiron, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Komisioni e ka shqyrtuar dhe aprovuar dhe i rekomandon seancës aprovimin e ligjit.

Ka një problem teknik që ka rrjedhë. Te amendamenti i parë, mungon fjala “amendamenti 1”, që duhet të përmirësohet, se ka rrjedhë si problem teknik. Ndërsa probleme tjera nuk ka dhe i rekomandojmë seancës që ta aprovojë ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë vërejtjen, në qoftë se duhet të merret parasysh nga ne...

E votojmë amendamentin 1.

Nuk ka “kundër”, miratohet amendamenti.

Amendamenti 2.

A ka vërejtje? Nait Hasani!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues! Nuk është çështja veç për amendamentet, por komplet ligji është i papajtueshëm. Ata që e kanë prurë ligjin dhe përfaqësuesi që e ofroi, thotë “mbrojtjen e dëshmitarëve”, cilët janë dëshmitarët. Thotë: “të dhënat personale, të dokumenteve të reja, në bazë të të dhënave, nuk mund të jenë të dhëna të njëjta me ato tjerat, mbi personin...”

KRYESUESI: Nait, ne i kemi kaluar të gjitha procedurat. Unë parëz Liburnit nuk ia dhashë as në emër të Grupit, ti po lyp... për diçka që është kaluar.

NAIT HASANI: Të lutem! Personi i mbrojtur... Të lutem, kryesues!

KRYESUESI: Ke të drejtë, po edhe Liburni ka pasur të drejtë më parë. Ndoshta e kam pasur gabim.

NAIT HASANI: Çfarë ligje po miratojmë, për kë po i miratojmë këto ligje?

KRYESUESI: Po mirë de, tash...

NAIT HASANI: Kë duhet mbrojtur? Ne përpara i kemi quajtur spiunë, tash spiunët po i quajmë dëshmitarë! Si do t'i mbrojmë këta? Thotë, do ta bëjë maskim plastik... Të lutem! Unë kërkoj prej kryesuesit ta heq, ta kthejmë këtë.

KRYESUESI: Nait, unë nuk e kam sjellë ligjin, nuk e kam proceduar unë, ka kaluar të gjitha komisionet, kam dhënë edhe unë vërejtjet e mia.

NAIT HASANI: Nëse është një turp i komisionit, ky është turpi që e ka miratuar.

KRYESUESI: Unë mendoj që edhe neve e kemi një mundësi që të kërkojmë nga presidentja, në qoftë se s'ju pëlqen ligji, mund të kërkonim me procedurë që të mos e nënshkruajë dhe ta kthejë në Parlament, kjo na mbetet, ose t'i votojmë amendamentet një nga një. Në qoftë se ka dikush kontestuese në një amendament, prapë mund të japë vërejtje dhe ta qesim në votim. Kjo është mundësia ime sot, si kryesues i seancës. Tjerat pastaj...

Zoti Gjini e ka kërkuar fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se duhet bërë një sqarim shumë të vogël. Po flasim për mbrojtje të dëshmitarëve dhe kjo ka të bëjë esencialisht me sundimin e ligjit në Kosovë, ka të bëjë me mbrojtjen e shtetit të Kosovës dhe nuk po flasim kushtimisht për spiunët të cilët kanë punuar për shtetin e huaj, për okupatorin.

Domethënë, sot jemi në pozitë krejt tjetër, e sot nëse i mbrojmë dëshmitarët, sot i mbrojmë njerëzit të cilët kanë për të dëshmuar në favor të sundimit të ligjit në Kosovë, në shtetin tonë.

Do të thotë, unë e kuptoj kolegun Nait Hasani, por mendoj se situata në të cilën ne po bëjmë ligj për mbrojtjen e dëshmitarëve është krejt tjetër. Po e përsëris, ne po bëjmë ligj për mbrojtje të dëshmitarëve në shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës dhe jo në situatën në të cilën dëshmitari mbrohet për shkak se punon për një okupator. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Jo, çështja është që ne nuk jemi në fazën kur e vlerësojmë ligjin në tërësi. Ne jemi në fazën e leximit të dytë, që janë amendamentet, që komisionet i kanë aprovuar dhe kanë ardhur te ne.

Ne kemi procedurën dhe ju, zoti kryesues, në të vërtetë e thatë thuaja të gjithën. Qeveria edhe në këtë fazë ka të drejtë ta tërheq ligjin, nëse do. Është e drejtë e saj, se është sponsor Qeveria.

Po, Parlamenti në këtë fazë nuk ka të drejtë të ndalet. Domethënë, pos asaj që thatë ju, ka të drejtë ta kontestojë nënshkrimin e tij, kështu që sot nuk është koha ta bëjmë vlerësimin total të ligjit, si i keq, i mirë ose i shkruar keq ose i menduar keq. Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani do të hapet debat, po më duket, për këtë çështje. Unë s'po di! Zoti Bajrami, e keni fjalën!

FATMIR BAJRAMI: Do të jem jashtëzakonisht i shkurtër! Ky ligj ka kaluar gjitha procedurat, është sponzoruar nga Qeveria dhe tani është vonë për ta rikthyer. Mirëpo, në amendamentin e fundit, ata që do ta lexojnë amendamentin e fundit, kemi vendosur një rregull se çfarëdo mashtrimi apo lajthimi i të ashtuquajturve “dëshmitar i mbrojtur” inkriminohet penalisht si vepër penale, kështu që...

(Ndërhyrje)

Jo, është vepër penale! Domethënë, në Kodin penal do të parashihet si vepër penale dhe ky ligj në fakt ka qenë edhe një nga ligjet e kërkuara edhe me Raportin e progresit.

KRYESUESI: Hajde, Alma, s'është për media, kjo Alma!

ALMA LAMA: Jo, vetëm për këtë fjalën “lajthimi” e kisha fjalën unë. Thuhet: “lajthitje” në gjuhën shqipe, jo “lajthimi”. Domethënë, mendoj se duhet të ndryshohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, fillojmë me votimin.

Amendamenti 1.

(Ndërhyrje)

Çka ka lidhje që nuk është Qeveria. Ne e votojmë, o burrë!

Amendamenti 1.

A ka kundër? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

1 “kundër”. Miratohet.

Amendamenti 3.

1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 4.

1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 5.

1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 6.

1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 7.  
1 “kundër”. Miratohet.

Amendamenti 8.  
1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 9.  
1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 10.  
Nuk ka “kundër”, miratohet.

Amendamenti 11.  
1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 12.  
1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 13.  
1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 14.  
1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 15.  
1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 16.  
1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 17.  
1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 18.  
1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 19.  
1 “kundër”, miratohet.

Amendamenti 20.  
1 “kundër”, miratohet.

Ky ishte amendamenti i fundit. Tani përgatitemi të votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Konstatohet se në sallë janë 69 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Faleminderit! Me 54 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, konstatohet se Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Pika e tetë e rendit të ditës:

### **8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për verërat**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për verërat dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votim të amendamenteve, ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputetin Nait Hasani që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Nuk ka.

Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raportin e komisionit funksional.

Amendamenti 1.

Nuk ka kundër, miratohet.

Amendamenti 2.

Nuk ka kundër, miratohet.

Amendamenti 3.

Nuk ka kundër, miratohet.

Amendamenti 4.

Nuk ka kundër, miratohet.

Amendamenti 5.

Nuk ka kundër, miratohet.

Amendamenti 6.

Nuk ka kundër, miratohet.

Tani e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e propozuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim!

Në sallë janë 70 deputetë.

Votojmë tani:



Konstatohet se me 59 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për verërat.

### **9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës**

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka kërkuar nga Kuvendi afat shtesë për paraqitjen e raportit për Projektligjin për ndryshimin e plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Kërkoj nga deputetët që me ngritje dore të deklarojnë për propozimin e komisionit.

Atëherë votojmë, a jeni për ta mbështetur këtë propozim të tyre, apo jo?

(Ndërhyrje)

Po, mirë de! E shtyjme! A ka “kundër”? Nuk ka “kundër”.

Konstatohet se Kuvendi miratoi propozimin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim për afat shtesë për një muaj për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Urdhëro! Zoti Kuleta e ka fjalën!

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryesues!

Kur u lexua, para votimit nuk u përmend afati një muaj. E po, unë e kam një vërejtje këtu, sepse konsideroj që kjo nuk duhet të kushtëzohet me afat një muaj ose diçka. Procedimi i këtij projektligji është në kundërshtim, domethënë nuk është në pajtim me Kushtetutën për deri sa Kushtetuta nuk i ka amendamentuar, prandaj konsideroj se kjo duhet të lidhet me Kushtetutën. Në momentin kur të miratohet Kushtetuta me ndryshime, atëherë të vazhdojë procedura për ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe unë konstatova të njëjtën gjë, por mendoj se ne e votuam propozimin që të shtyhet. Dhe ai një muaj doli pasi u votua, kështu që mbetet pa afat. Kur të bëhen kushtet, bën edhe një muaj, bën edhe dy javë, bën edhe sa të ketë nevojë.

Pika e dhjetë e rendit të ditës:

### **10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmën juridike falas**

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndihmën juridike falas dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj raportuesin e komisionit funksional, zotin Gashi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Komisioni e ka shqyrtuar këtë ligj dhe i rekomandon seancës që ta aprovojë. I plotëson kriteret teknike dhe besojmë që është i rëndësishëm në aspektin e aprovimit të tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Hadërgjonaj!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, sipas Rregullores është i obliguar që të shqyrtojë implikimet buxhetore apo koston shtesë buxhetore të cilën i kanë projektligjet.

Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar ligjin, amendamentet të cilat i ka sjell Komisioni për Legjislacion, por njëkohësisht edhe ligjin i cili ka ardhur dhe ka konstatuar se ky ligj, ky projektligj në fakt ka implikime buxhetore dhe ka rekomanduar që të mos miratohet.

Obligimet shtesë të cilat dalin nga ky projektligj janë prej 541.168 euro, në kategoritë ekonomike, paga e mëditje, mallra dhe shërbime dhe shpenzime kapitale, si dhe parashihet rritja e numrit të punëtorëve për 30 pozita gjatë vitit 2011-2013, e cila kosto dhe numër shtesë i punëtorëve nuk janë të përfshira në buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe në Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2012-2014.

Nenet 20, 21, 24, 25 dhe 30 të Projektligjit që kanë të bëjnë me pagesën e anëtarëve të Këshillit për ndihmën juridike falas, themelimin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas me strukturë të re organizative, personeli shtesë i Agjencisë, ofrimi i ndihmës juridike nga zyrat mobile dhe zyrat rajonale për ndihmë juridike falas nuk janë të qartësuara sa duhet dhe krijojnë kosto të drejtpërdrejta buxhetore shtesë dhe rritje të numrit të punësuarve, i cili numër i të punësuarve nuk është i përfshirë as në buxhet dhe as në Kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Unë dua ta njoftoj Kuvendin, sepse kam marrë nga stafi i administratës 26 agjenci të pavarura janë formuar, të cilat i raportojnë Kuvendit. Një agjencion faktikisht tani për tani e kemi edhe pa mjete buxhetore, kurse është agjencioni i 27 i cili formohet dhe i cili duhet t'i raportojë Kuvendit. Domethënë, po e bëjmë edhe një qeveri në veti me agjencione të pavarura.

Duke vlerësuar koston buxhetore, sidomos kërkesën e lartë për rritjen e numrit të punëtorëve për implementimin e këtij projektligji, komisioni njëzëri ka rekomanduar që projektligji të mos miratohet dhe vlerëson të rëndësishme mbajtjen e takimeve të përbashkëta në Komisionin funksional për Legjislacion, sponzorizuesin dhe përfaqësuesit nga Ministria e Financave për të harmonizuar qëndrimet dhe për të bërë ndryshimet e caktuara në nenet të cilat i përmenda më lart.

Domethënë, disa ndryshime që mund të bëhen në nenet më lart, mund të harmonizohen në mes të komisioneve, prandaj kisha rekomanduar që ky lexim i dytë i projektligjit të shtyhet për një mbledhje të ardhshme.

Përndryshe, unë mund të japë edhe arsyetimet në secilin nen për të cilin po kërkoj që kërkon harmonizim edhe të mëtutjeshëm. Ne kemi drejtuar rekomandimin tonë Komisionit për Legjislacion dhe ka qenë mirë që paraprakisht pa dal në rend dite të diskutohet bashkërisht me Komisionin për Legjislacion, me sponsorizuesit dhe me Ministrinë e Financave për të harmonizuar qëndrimet lidhur me këtë çështje.

Dua të them, vetëm në nenin 20 parashihet që anëtarët e Këshillit të mbajnë mbledhje të rregullta dhe gëzojnë honorare në shumën e përcaktuar sipas dispozitave të brendshme të Kuvendit të Kosovës. Hajt t'më thotë dikush çfarë dispozitash të brendshme ka Kuvendi i Kosovës për të përcaktuar shumë të cilat paguhen në këshillat nëpër agjencione. Zakonisht, Kuvendi nuk ka dispozita të brendshme për përcaktimin e pagave të anëtarëve të këshillave apo agjencioneve të pavarura të themeluara prej Kuvendit, pagat apo honoraret e këtyre institucioneve të caktohen direkt me ligjin e atij agjencioni.

Prandaj, ne kemi laramani të madhe të këtyre agjencioneve, ka nevojë edhe pak për konsulta dhe kisha propozuar që të shtyhet për një seancë tjetër ky projektligj dhe të mos miratohet. Përndryshe s'ka kurrfarë efekti shqyrtimi nga ana e Komisionit për Buxhet e Financa, kostoja shtesë buxhetore e projektligjeve.

KRYESUESI: Faleminderit! Pak na e keni... Është dashur të merremi vesh pak më herët që të diskutohet edhe në Kryesi, por... Fjalën e ka deputeti Hamiti!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja kryetare e komisionit foli shumë qartë dhe me argumente. Kostoja është e madhe.

Neni 41 i këtij ligji, hyrja në fuqi, thotë "ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në gazetë zyrtare", që i bie shpejt.

Dhe, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e mbështes shtyrjen në leximin e dytë. Domethënë, pezullimin, të mos votohet sot, të shkojë në një mbledhje tjetër, në mënyrë që të shikohet mundësia a mund të hyjë në fuqi ky ligj, a ka arsye dhe a ka mbulesë financiare.

Nëse e qet në votim këtë propozim të zonjës, ne do ta votojmë që të shtyhet leximi i dytë.

KRYESUESI: Fjalën e ka kërkuar edhe një herë, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Veç sa për sqarim shtesë. Sa i përket Komisionit për Legjislacion, ne e kemi trajtuar në aspektin profesional dhe teknik këtë ligj. Ky ligj në aspektin profesional dhe teknik ka marrë përkrahjen e komisionit.

Sa i përket aspekteve financiare, duhet të kemi parasysh dy elemente. E para, ky ligj është ligj i sponsorizuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që i bie nga Ministria e Drejtësisë, që i bie me fjalë tjera, nga shumica e Qeverisë ose shumica parlamentare që e përkrahu këtu, që zonja nuk po e përkrah ligjin.

Dhe, e dyta, sa iu përket çështjeve financiare dhe teknike, është dashur ta arsyetojë Ministria e Financave me Komisionin për Buxhet e Financa, jo me Komisionin për Legjislacion. Ne e shohim aspektin juridik dhe profesional, këto kritere juridike dhe profesionale i plotëson, e sa i përket çështjeve financiare dhe ekonomike, t'i marrë parasysh Qeveria ose shumica parlamentare. Ne nuk e kemi për detyrë që t'i marrim përsipër këto gjëra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Këtu s'kemi të bëjmë as me shumicë, as me pakicë, problemi është, propozimi është, po mendoj edhe unë jam me zotin Hamiti, i arsyeshëm. Janë paraqitur edhe dy deputetë, unë besoj se qëndrimi i dy komisioneve është i qartë. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së është i qartë, do të thotë është një mocion në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së...

(Ndërhyrje)

Është edhe propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ju e dini që sipas rregullave, në qoftë se nuk ka mbulesë financiare, ligji s'ka kuptim që të miratohet. E meta është që Komisioni për Buxhet dhe Financa është dashur që të komunikojë me Kryesinë e Kuvendit që të mos vjen ky ligj sot në diskutim këtu, prandaj unë e qes në votim propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe, në fakt, propozimin e Komisionit për t'u shtyrë në një seancë të ardhshme Projektligji në fjalë.

Kush është për t'u shtyrë?

Edhe një herë, për vëmendje të deputetëve. Unë po e hedh në votim, votoj me dorë. Kush është për t'u shtyrë për një seancë tjetër? Faleminderit!

Kush është "kundër"? 1 është "kundër".

Shumica absolute është që Projektligji, i propozuar për shqyrtimin e dytë, për ndihmën falas juridike të shtyhet për një seancë të ardhshme deri sa të harmonizohen çështjet me financa. Faleminderit!

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës, është:

#### **11. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010**

Konstatime hyrëse. Komisioni funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar raportin e Auditimit të Pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2010 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij bashkë me rekomandimet e komisionit funksional.

Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i komisionit funksional, deputeti Ali Sadriu, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Zoti Sadriu, e keni fjalën!

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!  
Të nderuar kolegë deputetë,

KRYESUESI: Mikrofonin, nëse bën Ali ta ofrosh pak!

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!  
Të nderuar delegatë,  
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka kryer auditimin e rregullsisë së Pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin fiskal 2010 dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike i ka paraqitur raport me rekomandime.

Komisioni shqyrtoi këtë raport në mbledhjen e mbajtur më 20 korrik 2011. Të ftuar në këtë mbledhje ishin kryetari i Bordit, drejtori i përgjithshëm. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Zyrës së Auditorit Gjeneral.

Opinionin i ZAP-it lidhur me këtë raport është opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes. Gjatë shqyrtimit të raportit, Komisioni ka konstatuar se të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë mjaft serioze, sidomos adresimi i rekomandimit nga vitet e mëhershme, mjedisi jo funksional i kontrollit të brendshëm, ende nuk janë plotësuar të gjitha pozitat me staf të mjaftueshëm, pastaj procedurat e prokurimit nuk ishin zhvilluar në pajtim të plotë me kornizën e aplikueshme ligjore. RTK nuk ka themeluar njësinë e auditimit, pastaj auditimi i brendshëm nuk është funksional.

Si rezultat i kësaj, e me qëllim të mbikëqyrjes së adresimit...

KRYESUESI: Ju lus për qetësi, sepse është duke e lexuar raportin...

ALI SADRIU: Dhe është një rekomandim, realisht tri rekomandime që shkojnë këtu, prandaj ZAP-i dhe komisioni është i të njëjtit mendim që t'i rekomandojë Radiotelevizionit të Kosovës që në afat prej 3 muajve me raport me shkrim ta njoftojë Kuvendin përmes komisionit për veprime të ndërmarra rreth të gjeturave të Zyrës së Auditorit Gjeneral.

Rekomandimi i dytë ka të bëjë, Komisioni ka konstatuar se ka nevojë për një auditim të performances. Këtë rekomandim ia kemi adresuar Zyrës së Auditorit Gjeneral, sepse auditimi i performances është auditim që tregon efektshmërinë e punës së një institucioni.

Dhe,, rekomandimi tretë që i adresohet Kuvendit, ka të bëjë me krijimin e mundësive që në pikën e Goleshit dhe të Cvilenit të vendosen antenat e Radiotelevizionit, në mënyrë që Radiotelevizioni i Kosovës të mbulojë të gjithë territorin e Kosovës. Nëse nuk është e mundur në këto dy pika për shkak të reagimeve të KFOR-it, të hulumtohen pika tjera, sepse ka pjesë të Kosovës të cilat nuk janë të mbuluara.

Një ankesë të veçantë e kemi pasur edhe prej komunitetit goran në Sharr, se Radiotelevizioni nuk ka qasje në atë pjesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kush e ka fjalën? Valbona Dibra!

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e auditimit të Pasqyrave financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010.

Zyra e Auditorit Gjeneral të Kosovës ka bërë auditimin e rregullsisë për Pasqyrat financiare të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2010.

Opinionin e Auditorit për Pasqyrat financiare të Radiotelevizionit të Kosovës është i pakualifikuar me theksim të çështjes, çka do të thotë se pasqyrat kryesore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë gjendje të drejtë dhe të vërtetë. Ndërsa, theksimi i çështjes është sa i përket pasqyrës së shpalosjes, e cila nuk ishte shumë e qartë dhe disa zëra nuk korrespondojnë me pasqyrat tjera financiare.

Auditori ka konstatuar se RTK gjatë vitit 2010, shikuar në tërësi, kishte një realizim të mirë të buxhetit, por dobësi kishte vërejtur te buxheti i shpenzimeve nga të hyrat vetjake.

Me gjithë punën e mirë që e ka bërë Radiotelevizioni i Kosovës gjatë vitit 2010, Auditori ka konstatuar disa dobësi në fushën e menaxhimit financiar dhe për këto dobësi Zyra e Auditorit Gjeneral ka dhënë disa rekomandime. Është e rëndësishme se menaxhmenti i RTK-së është zotuar se do të bëjë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Përkundër zotimit të menaxhmentit të RTK-së për adresimin e rekomandimeve, ne si Grup parlamentar presim nga RTK implementimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditori Gjeneral.

Dua të ceku se një ndër sfidat të cilat ka RTK, është mos shtrirja e sinjalit në tërë territorin e Kosovës. Për këtë çështje menaxhmenti i RTK-së ka kërkuar mbështetje nga Kuvendi i Kosovës për vendosjen e antenave në pikën e Goleshit dhe të Cvilenit apo në ndonjë pikë tjetër ku mund të ketë shtrirje të sinjalit të RTK-së në tërë territorin e Kosovës.

Grupi ynë parlamentar ka shprehur gatishmërinë t'i ofrojë mbështetje në zgjidhjen e këtij problemi, i cili është në interes të publikut. Dhe, në fund, ne si Grup parlamentar e përkrahim raportin e lëshuar nga Zyra e Auditorit Gjeneral. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, kush dëshiron fjalën? Ali Sadriu, propë e kërkon fjalën!

ALI SADRIU: Në këtë rast s'do t'i kisha përsëritur ato konstatimet që i dha Komisioni më herët, përjashtimisht nëse duhet diçka për të shtuar. Është mirë që Zyra e Auditorit Gjeneral më në fund ka kuptuar se ka nevojë për auditime të performancës dhe po e shqyrton mundësinë që ta zgjerojë gamën e auditimeve të tilla dhe ne në një analizë të tillë, në një auditim të tillë do të kishim shumë më të dhëna konkrete se këto që ne po i shqyrtojmë sot.

Megjithatë, unë shpresoj dhe pres që brenda 3 muajve Radiotelevizioni i Kosovës do t'i shpalosë të gjeturat, do të reflektojë në to dhe do të na njoftojë për hapat që kanë ndërmarrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Lama!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi ynë parlamentar i mbështet rekomandimet që kanë ardhur nga Komisioni për Mbikëqyrje Financiare.

Madje ne do të shkonim më tutje, me një propozim, duke mbështetur propozimin dhe idenë që në vazhdimësi e ka bërë në Kuvend kryetari i komisionit, zoti Ali Sadria, në lidhje me raportet e auditimit dhe raportet e punës që vijnë nga institucionet e ndryshme.

Për të rritur rolin mbikëqyrës të Kuvendit dhe për të shqyrtuar më mirë raportet ose punën e një institucioni të caktuar, është shumë e rëndësishme që si raporti i punës, ashtu edhe raporti i auditimeve financiare të vijnë në të njëjtën kohë. Vetëm në këtë mënyrë deputetët do të kenë mundësinë që të shohin performancën e vërtetë të një institucioni të caktuar.

Besoj se kjo do të ishte procedura më e drejtë dhe më e mirë për të shqyrtuar punën e këtyre institucioneve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar AAK, deputeti Bali Muharremaj!

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka shqyrtuar raportin e auditimit për Pasqyrat vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2010.

Pasi Radiotelevizioni i Kosovës pjesën më të madhe të hyrave për vitin 2010 apo rreth 85% të saj e kishte realizuar nga buxheti i Kosovës, është mirë që ky medium është audituar nga vetë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, e jo ndonjë kompani private e audituar, siç kishte ndodhur në vitet e kaluara.

Auditimi i jashtëm i RTK-së ka nxjerrë në pah parregullsitë që lidhen direkt me mungesën e kontrollit të brendshëm nga menaxhmenti dhe Bordi i RTK-së.

Shqetësimet tona që dalin nga ky raport kanë të bëjnë me dobësitë në menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve si dhe pasurisë, pastaj mosrespektimi i procedurave të prokurimit, shpalosjet jo të qarta të pasqyrave financiare dhe, për më tepër, auditimi i brendshëm nuk është funksional dhe është shpërfillur në tërësi nga menaxhmenti.

Kjo neglizhencë ka rrezikuar seriozisht arritjet e objektivave të përcaktuara në shfrytëzimin sa më të mirë të parave publike, andaj kërkoj që të forcohet njësia e auditimit të brendshëm që ka funksion të rëndësishëm në zbatimin e mekanizmave të kontrollit në çdo institucion.

Grupi Parlamentar i Aleancës i përkrah rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Sevdije Lama!

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re përkrah raportin e auditimit të Pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2010.

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”, Albert Kinolli!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar raportin e aludimit të Pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2010 dhe mendon se nuk ka pasur parregullsi të theksuara dhe e përkrah këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Në sallë janë 63 deputetë. Vazhdojmë me votimin e Raportit të auditimit të Pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2010.

Konstatoj se në sallë janë prezentë 63 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Konstatoj se me 62 vota “për”, 1 abstënim, 1 “kundër”, Kuvendi miratoi Raportin e auditimit të Pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit për vitin 2010.

Grupi Parlamentar i PDK-së e shtyn për një seancë tjetër emërtimin e një përfaqësuesi në Komisionin për të Drejtat e Komuniteteve dhe për Kthim.

Pika e trembëdhjetë, si njoftim:



### **13. Propozimi i Grupit parlamentar të SLS për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**

Grupi Parlamentar i SLS ka propozuar zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, në vend të deputetit Vesimir Saviq, do të jetë deputeti Milivoje Stojanović.

Kërkoj nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar të SLS-së.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Pika e katërbëdhjetë:

### **14. Propozimi i Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re për emërimin e anëtarit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës**

Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re e ka propozuar zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës, në vend të ish deputetit Ibrahim Makolli, do të jetë deputeti Emin Gërbeshi.

Kërkoj nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re.

Konstatohet se Kuvendi miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të AKR-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Ju njoftoj se pushimi i Kuvendit, i deputetëve, është nga data 1 gusht deri më 20 gusht. Do të thotë, një anëtar i Kryesisë është kujdestar këtu, në qoftë se keni ndonjë hall.

Faleminderit për durimin! Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

**Njësia për Transkriptim dhe Lekturë e Kuvendit të Kosovës**